

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7761 E diel 13 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

**I**kemi votuar politikanët tanë, edhe Lmë të lartët e piramidës, të jenë pranë nesh në nevojat që kemi si qytetarë. Me fjalë kanë qenë përherë. Janë bërë ...  
Vijon në faqen 21


## Nga FATOS ÇOÇOLI

**"E lagu s'e lagu" i sotëm politik**  


## Opinion i Ditës

**M**e të vetmen aftësi reale që i Mka mbetur, atë të një aktori të mirë që duhet të nxjerrë në skenë një personazh të ngjizur keq, Edi Rama hodhi një ide ...  
Vijon në faqen 22

## Nga ANDI BUSHATI

**Kush qe Çani, Edi apo Ariani?**  





Slogani i ri: "Shqipëria, shtëpia juaj"  
**Konventa e LSI-së, Kryemadhi: Misioni ynë, luftë të keqes, të kthejmë shqiptarët**

"Ta kthejmë LSI-në në Lëvizje të Solidaritetit Kombëtar". Luan Rama: Jemi me rininë e vendit  
VALENTINA MADANI  
LSI mbledhi dje Konventën Kombëtare nga ku u zbulua dhe slogani për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019. "Shqipëria, shtëpia juaj", do të udhëheqë LSI-në gjatë fushatës elektorale për zgjedhjen e drejtuesve të rinj ...  
Në faqen 4

## PERPLASJA/ KRYEMINISTRI: GJKATA KUSHTETUESE DO T'I JAPE FUND MASKARADES

# RAMA: KUSHTETUTA "PENG". META: MPJ, JO AUTOSHKOLLE

Kthimi i emërimit të Gent Cakajt si ministër i Jashtëm, kreu i shtetit: PS ka plot emrat të denjë për kryediplomat. Nuk lejoj ndryshim kufijsh



(Në foto) Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

## HISTORIA E "TARZANIT"

**Shtypi italian: Kokaina dhe misteri i vrasjes së tre vetëve në Elbasan**  
Në faqen 7

## GRABITJA

**Rikthehen maskat, lidhin familjen e biznesmenit dhe i marrin 10 mijë euro**  
Në faqen 6

## KRYETARI I PD

**Basha, Ramës: Mos nxit konflikt civil, po ritenderohet loti 1 i Unazës**  
Në faqen 5

## RRIFIMI NE POLICI

**Grabitja e armëve në Pashaliman: U largova nga shërbimi, sepse ishte frotë**  
Në faqen 6

### TABELAT



**Pensionet në 2019, zbardhen koeficientët për të llogaritur masën e përfitimit**  
Në faqen 10-11

## MILITARIO Historia e shqiptarëve të Moresë që u shfaqën pas epokës së Skënderbeut

# Stratitotët, mercenarët e frikshëm të Europës

Në brendësi: Shqipëria në enciklopedinë polake të 1859. Monografi për Ismail Qemalin?

NGA LUAN RAMA  
**H**istoria e vjetër e shqiptarëve gjithnjë e më shumë na zbulon bëma e ngjarje të habitshme, ku jo rrallë shqiptarët janë protagonistë dhe aktorë vendimtarë të ngjarjeve të mëdha jashtë territoreve shqiptare. Dhe



kur këto bëma, këta emra kalorësish dhe politikanësh të shquar; i ndesh në faqe librash mesjetare, të ngjan se në hirin e kohërave zbulon gurë të shndritshëm, sikur ato prushe të jenë fshetur ashtu, për të mos u shuar kurrë. Të tillë ishin stratitotët ...  
Suplement

## PËRPLASJA "CAKAJ"

Kryeministri: Meta është katandisur në çizme rezervë të Doktorshës së shkencave

# Rama replikon me presidentin: Je pengmarrës i Kushtetutës

"Gjykata e re do i japë fund maskaradës"

Përplasjet mes Presidentit Ilir Meta dhe kryeministrit Edi Rama vazhdojnë të jenë prezente prej ditësh lidhur me kandidaturën e Gent Cakajt si ministër i Jashtëm. Disa orë, pasi kreu i shtetit, deklaroi se Ministria e Jashtëm nuk është një autoshkollë, ku ustai i madh kërkon të mësojë 'gjenium' si të ndryshojë kufijtë e të gjithë Ballkanit Perëndimor", Rama i është kundërpërgjigjur duke thënë se "Mos prisni të merrem më me një pengmarrës të Kushtetutës në zyrën e Presidentit, i cili është katandisur në çizme rezervë e Doktorshës së Shkencave". Gjykata e re Kushtetuese do t'i japë fund kësaj maskarade, ndërsa vëmendja jonë do jetë e gjitha të njerëzit e zero të çizmet", - u shpreh kreu i qeverisë. Reagimit të kryeministrit Rama, në përgjigje të Presidentit Meta në vijim të replikave të ashpra për mosdekretimin e Gent Cakajt si ministër të Jashtëm, "se nuk do të merret me një pengmarrës", iu përgjigj këshilltari i kreut të shtetit, Tedi Blushi i kujtoi Ramës se "Nuk ka komision garancish statutores që ndalon Presidentin e Republikës të ushtrojë kompetencat e tij të qarta kushtetuese për emërim e shkarkim ministrash". "Nuk ka komision garancish statutores që ndalon Presidentin e Republikës të ushtrojë kompetencat e tij të qarta kushtetuese për emërim e shkarkim ministrash. Duhet të jetë e qartë për pengmarrësin e Reformës në Drejtësi: Aksioni për rivendosjen e plotë të rendit kushtetues e ligjshmërisë nuk ndalet!", deklaroi z.Blushi. Edhe dy ditë më parë Kryeministri Edi Rama bëri akuza të forta ndaj Ilir Metës në studion e emisionit "Zonë e Lire"



Kryeministri Edi Rama

### EDI RAMA

"Mos prisni të merrem më me një pengmarrës të Kushtetutës në zyrën e Presidentit, i cili është katandisur në çizme rezervë e Doktorshës së Shkencave. Gjykata e re Kushtetuese do t'i japë fund kësaj maskarade, ndërsa vëmendja jonë do jetë e gjitha të njerëzit e zero të çizmet" shprehet z.Rama.

### "Kryeministri i lajthitur, qëndroni larg tij"

## Vasili-Ramës: Për Metën ke thënë se është presidenti më i mirë

Kreu i deputetëve të LLSI-së, Petrit Vasili këshilloi shqiptarët të qëndrojnë larg kryeministrit Rama, për të cilin shkruan se është një i lajthitur. Ndërkohë që mes presidentit dhe kryeministrit ka pasur shkëmbim replikash të ashpra, pas mosdekretimit të Genc Cakajt si ministër i Jashtëm, Vasili publikoi fjalët që Rama ka thënë më herët për Presidentin Meta, kur u zgjodh president. "Ky shpifurinë logjike kryeministër në maj të 2018, pra 7 muaj më parë lexoni çfarë thoshte për Ilir Metën President: "Ajo që unë vlerësoj është pozici-



cioni që ai mban. Nëse nuk do ishte Meta, por një person që s'do kishte bagazh nga e shkuara do ishte shumë keq. Është presidenti më i mirë që kemi pasur"- u shpreh Rama në "ABC". Ndërsa po ky shpifurinë logjike kryeministër që i hoqi edhe portretin ja çfarë thotë sot për Bujar Nisha-

nin: "Nishani meriton sot respekt për shkak të Metës se pavarësisht se u bë qesharak, ishte partiak, s'ka arritur aty ku ka arritur Meta që ka sfiduar rendin kushtetues", tha Rama. Rrijini larg këtij të marri që s'di ç'flet, mos e afroni që të mos vini erë edhe ju vetë!", u shpreh z.Vasili.

duke thënë se Presidenti ka shkelur rëndë dhe në mënyrë të përsëritur Kushtetutën. Me vendimet e fundit, sipas Ramës, Meta po vepron si të ishte kryetar i LLSI-së. Rama akuzoi presidentin se ka vepruar me dy standarde për ministrat për çështjen e certifikatës së sigurisë. Për këto deklaratat

reagoi dje Presidenti Meta sipas të cilit Ministria e Jashtëm nuk mund të kthehet në autoshkollë. Por pavarësisht replikave që vazhdojnë prej ditësh mes krerëve të dy institucioneve më të larta në vend mbetet e paqartë si do të zgjidhet çështja e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme. Ngërçi shkaktoi

si problem të parë dështimin e një takimi të kreut të diplomacisë shqiptare me shefen e politikës së jashtë të BE, Federika Mogherini në 10 Janar, pasi përveç mosdekretimit të ministrit të ri, presidenti nuk është shprehur me dekrete as për shkarkimin e ministrit Ditmir Bushati.



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat

### REAGIMI

"Nuk ka komision garancish statutores që ndalon Presidentin të ushtrojë kompetencat e qarta kushtetuese për emërim e shkarkim ministrash. Duhet të jetë e qartë për pengmarrësin e Reformës në Drejtësi: Aksioni për rivendosjen e plotë të rendit kushtetues e ligjshmërisë nuk ndalet!", deklaroi z.Blushi.

### "President, ju ftojme të ruani qetësinë"

## Balla-Metës: S'ju pengojmë dot të jeni Iliri qesharak

Taulant Balla, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, lëshoi dje akuza të forta ndaj Presidentit Ilir Meta për mos dekretimin e Gent Cakajt si kryediplomat. Në një shënim në 'Facebook', që vjen pas reagimit të Tedi Blushit, këshilltarit të kreut të shtetit, Balla e quan Metën "qesharak". "Zoti President, në s'ju pengojmë dot të jeni Iliri qesharak që kemi njohur më shumë se sa njëherë kur liderja e LSI ia fut kokën në çizmen e saj! Por këto bumjet tuaja që po e bëjnë Bujar Nishanin të duket si Xhefersoni, nuk impresionojnë dot askënd. Ne s'jemi as PD, as LSI dhe s'kemi ndërmend të humbasim kohë me konflikte të kota me ju", shkruan kreu i deputetëve socialistë. Më tej, Balla shton: "Sepse ju s'keni asnjë shans dhe s'do kenin asnjë mundësi të pengoni as punën tonë dhe as Reformën në Drejtësi, që e di Shqipëria dhe bota se sa shumë e dëshironi të realizohet. Por meqë ju kemi dhënë votën si President, ju ftojme të ruani qetësinë në të mundeni, sepse duke u bërë ju qesharak, sigurisht edhe ne nuk ndjehemi mirë".

### "Cakaj", ish-ministri i Jashtëm: Thjesht është një maskë

Deputeti dhe ish-ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Kas triot Islami i ftuar në emisionin "Kjo Javë" në News 24 foli për emrin e Gent Cakajt, i propozuar nga Rama si ministër i Jashtëm. Sipas tij, Gent Cakaj është një figurë e vogël. "Nuk është thjesht në nivelin e politikës së jashtme, më shumë se "furtunë" unë do e quaj si "maska", Gent Cakaj. Edhe në Kosovë nuk di askush detajet e marrëveshjes për integritetin e Kosovës, por as në Shqipëri nuk e di. Rama nuk është shprehur, ai ka lënë të kuptohet se është në dijeni. Rama ka heshtur duke mos shprehur asgjë, kjo ka një pjesë që lidhet me ministrin e jashtëm. Dua të them që askush nuk di detaje, por thuhet se do të preket integriteti i Kosovës", tha Islamaj.



Për ish-zëvendësministren e punëve të jashtme Edith Harxhi, Gent Cakaj duhet të shkarkohet nga detyra përpara se Kryeministri Edi Rama ta propozonte për drejtimin e politikës së jashtme shqiptare. Ish-zëvendës ministrja e këtij dikasteri i konsideron gafa diplomatike deklaratat publike të Cakajt për delimitimin e ujërave mes Shqipërisë dhe Greqisë. Për kapërcimin e situatës, krizës mes Presidencës dhe Kryeministrit, Edith Harxhi shprehet se Rama duhet të propozojë një emër të ri. Diplomata Harxhi e konsideron vendimmarrjen e Presidentit të Republikës për mos dekretimin e em-

"Gafa diplomatike e kandidatit për ministër"

Ish-zv/ministrja Harxhi: Rama ta shkarkonte Cakajn, jo ta promovonte



Ish-zëvendësministrja e punëve të jashtme Edith Harxhi

rit të Cakajt si veprim i duhur në mbrojtje të Kustetutës. Protestën e studentëve e konsideron mo-

mentin më kulminant të viteve të fundit që përkondhe me mungesën e një opozite të fortë. Sipas Har-

**AKUZA**  
Ish-zëvendës ministrja Harxhi i konsideron gafa diplomatike deklaratat publike të Cakajt për delimitimin e ujërave mes Shqipërisë dhe Greqisë.

hit zërat që e shikojnë protestën të zbehur gabojnë, pasi forca e saj ka një tjetër dimension. **GSH.al**

Presidenti: S'do e lejoj të ndryshojë të gjithë kufijtë e Ballkanit Perëndimor!

Valentina Madani

Presidenti i Republikës Ilir Meta vijoi dje rrethik në distancë me kryeministrin Rama në lidhje me refuzimin e dekretimit të Gent Cakajt në krye të diplomacisë shqiptare dhe faktin nëse ai ka shkelur ligjin sa i takon pajisjes me certifikate sigurie për zyrtarë të këtij niveli. Kreu i shtetit në postimin e tij në "Facebook" shkruan se Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë nuk mund të kthehet në autoshkollë. Meta e quan Ramën në mënyrë ironike Usta dhe Gent Cakajn një "gjeni" që sipas presidentit kërkon të ndryshojë të gjithë kufijtë e të gjithë Ballkanit Perëndimor. Meta shton se PS-ja ka plot emra, diplomatë të sprovuar e me eksperiencë për këtë post para se të propozojë emra që më shumë janë autoshkollë. "Sot, në momente të rëndësishme të sfidave tona rajonale, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë nuk mund të kthehet në autoshkollë ku ustai i madh kërkon të mësojë "gjenium" si të ndryshojë kufijtë e të gjithë Ballkanit Perëndimor. Partia Socialiste ka kapacitete të jashtëzakonshme në fushën e politikës së jashtme dhe Shqipëria ka shumë diplomatë të sprovuar, të cilët mund të vendosen në drejtimin e politikës sonë të jashtme, pa kaluar nga autoshkollja e ndryshimit të kufijve në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Shqipëria do jetë gjithmonë faktor paqe e stabiliteti në rajon. Shqipëria do ketë një lidhshmëri të besueshme edhe në kryesimin e OSBE-së. SHQIPËRIA E PARA", shprehet kreu i shtetit Ilir Meta. Dy ditë më parë Presidenti Ilir Meta kërkoi ngritjen e Komisionit Hetimor

Meta-Ramës: Ministria e Jashtme jo autoshkollë siç do ustai "PS-ja ka plot emra për kryediplomat"



Presidenti Ilir Meta

Parlamentar për hetimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK). Në një letër drejtuar kreut të Kuvendit, Gramoz Ruci dhe krenërve të grupeve parlamentare, Meta ka kërkuar që të hetohet dhënia e certifikatës së sigurisë për Gent Cakajn, i cili është pajisur nga DSIK gjatë një dite. Meta duke u ndalur tek informacioni i grumbulluar për Cakajn

para se të vendoste refuzimin e dekretimit të këtij të fundit si ministër të Jashtëm, shprehet se zv/ministri edhe ka refuzuar për një periudhë 7 muajore marrjen e certifikatës së sigurisë nga ana e DSIK. Certifikatë që është dhënë 3 ditë pasi kryeministri Rama e propozoi si ministër të Jashtëm. "Nisur nga fakti që Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është një institucion në varësi të

DEKRETI

Presidenti Meta firmosi dje dekretin për dhënien e gradës madhore "Gjeneral Brigade". Ndrëzim Reshit Sallaku. "Kolonel Ndrëzim Reshit Sallaku me detyrë "Atashe Usharak i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë", jo rezident në shtetin e Izraelit, Republikën e Azerbajxhanit dhe në Gjeorgji" i jepet grada "Gjeneral Brigade" - thuhet në dekretin e Metës.

drejtëpërdrejtë të Kryeministrit, është e qartë se procesi i hetimit administrativ nuk mund të kryhet nga organe të tjera në varësi të Kryeministrit, pasi krijohet një situatë e pastër e konfliktit të interesit, gjë e cila mund të cenojë objektivitetin dhe cilësinë e hetimit të këtij rasti, Presidenti i Republikës, vlerëson se, për rastin konkret, Kuvendi i Shqipërisë mund të realizojë objektivisht këtë proces hetimor. Shpreh besimin se Kuvendi i Shqipërisë do të përmbushë me përgjegjësi dhe seriozitetin e një institucioni, vend anëtar i NATO-s, angazhimet e tij në shqyrtimin e kësaj çështjeje të rëndësishme për vendin tonë dhe përgjegjësitë e tij kombëtare dhe ndërkombëtare", është shprehur z.Meta.

DEKLARATA

"Sot, në momente të rëndësishme të sfidave tona rajonale, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë nuk mund të kthehet në autoshkollë ku ustai i madh kërkon të mësojë "gjenium" si të ndryshojë kufijtë e të gjithë Ballkanit Perëndimor", shprehet z.Meta.

SHKURTE

Mosdekretimi i Cakajt, Ballist Morina: Përgëzimet e mia!

Ismail Ballist Morina, shqiptari që mori autorësinë e Ingridës së dronit në stadiumin Partizani të Beogradit, ka reaguar pas vendimit të Presidentit Ilir Meta për mos dekretimin e Gent Cakajt në postin e Ministrit të Jashtëm. Përmes një statusi në "Facebook", Morina përgëzon vendimin e kreut të shtetit, ndërsa shton se numri 1 i shtetit shqiptar mbështet pa rezervë integritetin territorial të Republikës së Kosovës. "Nuk mund të ishte ndryshe, numri 1 i shtetit shqiptar mbështet fuqishëm dhe pa rezervë integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Përgëzimet e mia të singerta në lidhje me qëndrimin tuaj rreth çështjes në fjalë. Respekte!!!", shprehet Morina.

Incidenti në Paris, Bushati mesazh ngushëllimi Francës

Pas shpërthimit të një furre buke në qendër të Parisit, ku katër persona humbën jetën reagoi dje edhe Ministri i Punëve të Jashtme në detyrë, Ditmir Bushati. Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", Bushati shpreh ngushëllimin në emër të të gjithë shqiptarëve në gjuhën frënge. "Trishtim dhe solidaritet i të gjithë shqiptarëve me parizanët dhe familjet e zjarrfikësve, viktimat të aksidentit të tmerrshëm të mëngjesit të sotëm në Paris", shkruan ministri i Punëve të Jashtme.

Njoftim për shitje me anka

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë të pasurisë të palles debitorëve Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Pësauria që detane ankand të parë përmbëhet nga: "Apartment", me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur në Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 3 Ap 14, Oriuk e regjistruar në ZV/PPP-Vlore, Z.K Nr.2832, volumni 16, faqe 120, me sipërfaq 43 m2. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.920.000 lekë. Ankandi do të zhvillohet në datë 25.01.2019 në orën 15:00 në selinë: Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 0672082543 ilir\_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-al.com.

Shoqëria permbirimore JUSTITIA sh.p.k anka ndin, faza e trete, për shitjen e pasurisë së palajshme, për të cilat ka vend hipoteke NISG BankWABI BANK, me këto të dhëna: Lloji njësi me sip. 189 m2 nr.pasurie 5/188/nd-n1, zk.8350 vol 28 fq.146 RR.P.Mezqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLJ. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 161784 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) EUR. Lloji apartament sip.132m2 zk.8350 nr.pas.5/188/nd+1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Mezoqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLJ. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 66.528 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) EUR. Secili ofertues që do të marrë pjesë në ankand duhet të depozitojë si garanci shumën prej 10 % të çmimit fillestar, në llogarinë e Shoqërisë Përmbirimore Justitia që është pranë Bankës "BKT Bank" sh.p.a. me numër IBAN AL 360511027444195601 PRICOLLAJA. Ankand zhvillohet në datën 12.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbanuesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijustitia.com, tel. +355 4 2279890

## OPOZITA AKUZAT

Konventa, zbulohet slogani i LSI-së për 30 qershorin, kandidatët në veting

# Kryemadhi: Të harrojmë idealin politik, të sakrifikojmë edhe jetën

"Ta kthejmë LSI në Lëvizje të Solidaritetit Kombëtar"

Valentina Madani

LSI mbledhi dje Konventën Kombëtare nga ku u zbulua dhe slogani për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019. "Shqipëria, shtëpia juaj", do të udhëheqë LSI-në gjatë fushatës elektorale për zgjedhjen e drejtuesve të rinj lokalë në mbarë vendin. Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi u bëri thirrje shqiptarëve që të dalin në protestë kundër qeverisë për të mbrojtur të ardhmen e fëmijëve. Kryemadhi me tone të ashpra në Konventën Kombëtare të LSI kërkoi bashkimin e qytetarëve përtej solidaritetit politik për të luftuar kundër asaj që e quajti "qeveri e rilindjes së krimit". "Ne jemi një popull që dimë të luftojmë. Kush ka tentuar ta shtypë e shfrytëzojë mund të ketë qenë i fortë, por fundi i tij ka qenë i frikshëm. Sot vendi ka një nga momentet e tij më të vështira, prandaj ne duhet të harrojmë idealin politik, sot e vetmja ideologji që duhet të qarkullojë, jo vetëm në LSI, por në gjithë klasën politike është vetëm një, Shqipëria është shtëpia jonë, atdheu, familja që duhet të kujdesemi si kujdesemi për shtëpinë tonë. Them sot një përkrahje të madhe për studentët që na dhanë dinjitet, shpresë, por mbi të gjitha na dhanë besim që të bashkuar do të fitojmë, jo politikisht, por për të fituar patriotikisht se sot është në diskutim çështja e vendit. Duhet të sakrifikojmë çdo gjë, edhe jetën, se çdo prind e jep jetën për të ardhmen e sigurtë të fëmijëve të tij. Ju e dini shumë mirë se Shqipërisë u premtuan 300 mijë vende pune, nuk pamë, por pamë mbi 400 mijë shqiptarë të larguar, por mijëra biznese të mbyllura dhe falimentuara, lot nënash që qanin se nuk kishin mundësi të ushqenin fëmijët", tha ajo. Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi bëri thirrje për bashkim përtej solidaritetit politik për të luftuar të keqen dhe renditi 26 premtimet e pam-

bajtura të qeverisë. "Nuk pamë 300 mijë vende pune, por 400 mijë të larguar. Të ngrihemi të luftojmë për të gjithë shqiptarët që ndihen të dobët. Të luftojmë për jetën e fëmijëve tanë. Le ta kthejmë Lëvizjen Socialiste

për Integrim në Lëvizje të Solidaritetit Kombëtar. Demokratët, socialistët, balistët e komunistët të krishterë e myslimanë të bashkohemi për kauzën e familjes tonë dhe Shqipërisë tonë vetëm kështu mund të bëjmë

ballë këtij uzurpimi që i ka bërë e keqja e Shqipërisë. Unë besoj se Shqipëria ka të ardhme prandaj lutem Zotit që t'ju japë të gjithëve ju forcë e besim të na falë mëkatet tona për mosverim ndaj kësaj të keqe që na ka kapluar. Jam mirënjohëse që kam përkrahjen tuaj. I lutemi Zotit të kemi një Shqipëri të begatë, të kthehen të rinjtë e të rejtat në Shqipëri për të ndërtuar të ardhmen e tyre", theksoi Kryemadhi. Në fund të Konventës, LSI miratoi edhe projektrezolutën, e cila konsiston në mbështetje dhe kontribut për procesin e integritit, të reformës në drejtësi, reformën zgjedhore. Gjithashtu, në këtë rezolutë LSI zotohet se kandidatët, të cilët do të kandidojnë në zgjedhjet e ardhshme do të kalojnë më parë në një proces vetingu.



Kryetarja e LSI  
Monika Kryemadhi

### PROJEKT REZOLUTA E LSI-SË, PËR INTEGRIMIN, REFORMËN NË DREJTËSI DHE ATË ZGJEDHORE

Lëvizja Socialiste për Integrim zotohet se:

- Do të japë gjithë kontributin e saj që Shqipëria të mos mbetet pas në rrugëtimin e saj evropian dhe që qershori të jetë muaji i çeljes së negociatave për anëtarësim. Ne jemi të bindur se kjo është e vetmja rrugë që vendi të kuadratohet dhe të funksionojë brenda kornizës së ligjeve dhe rregullave si çdo vend tjetër demokratik.
- Ne kemi qenën dhe mbetemi promotorët dhe mbështetësit më seriozë të reformës në drejtësi, ndaj dhe nuk do të lejojmë kapjen e reformës dhe deformimin e ndryshimeve kushtetuese konsensuale të Korrikut 2016. Krijimi i shtetit të se drejtës është një kusht jo vetëm për procesin e integritit evropian, por edhe të një jete me dinjitet për çdo qytetar shqiptar.
- Do të jemi konstruktiv në çdo çështje me ndjeshmëri të lartë nga qytetarët si dhe për çdo iniciativë ligjore që do ta përafroftë Shqipërinë me Bashkimin Evropian.
- Prioriteti ynë madhor është të bëjmë Shqipërinë vendin ku shqiptarët ndihen si në shtëpinë e tyre sërisht dhe të frenojmë në mënyrë emergjente largimin e të rinjve dhe qytetarëve nga vendi.
- Mbështetje politikave fiskale që ulin taksat në funksion të hapjes së më shumë vendeve të punës.
- Ne do të mbështesim çdo reformë zgjedhore që i jep zgjidhje fenomenit të shtitlerjes së votës dhe që garanton votën e lirë të qytetarëve shqiptarë.
- LSI po reformohet së brendshmi duke mësuar nga gabimet tona. Në zgjedhjet e ardhshme ne do të implementojmë një proces vetingu të kandidatëve, në mënyrë që secili nga kandidatët të plotësojë standarde të larta ku edhe do të firmosi një premtim publik për të emëruar vetëm njerëz të kualifikuar në administratën publike, duke qëndruar larg përkatësive partiake.

### LSI, Rama: Po ishim me studentët, Rama e keqja e Shqipërisë

Nënkryetari i LSI-së Luan Rama shprehu dje mbështetjen ndaj protestës së studentëve si përgjigje ndaj kryeministrit Edi Rama, i cili shpesh akuzonte opozitën si forca që fshihej pas protestës dhe bojkotit të studentëve. "Po ishim me studentët me protestën, sepse jemi me Shqipërinë dhe rininë e këtij vendi dhe të tjerët që bëhen xheloz le të rrinë në hallin e tyre dhe le të vazhdojnë të shohin si projekttohet fundi i agonisë së tyre", tha z.Rama. Jo vetëm kaq, LSI tha se me daljen në opozitë të LSI-së doli në dritë se kush është e keqja e Shqipërisë. "LSI asnjëherë nuk ka bërë pazar për interesat e vendit. Zgjedhëm opozitën për të humbur pushtetin, por fituam LSI pa makutë, batakinjët e servilët e hajdutët që sot janë në prehrin e rilindjes. "Jo vetëm i ikëm tepsi, por i treguam shqiptarëve se cila është e keqja që arriti të fshihej të kamufllohej e të fitonte nën imazhin e LSI-së", -tha deputeti i LSI.



Konventa Kombëtare e LSI-së

### THIRRJA

"Një përkrahje të madhe për studentët që na dhanë dinjitet, shpresë, por mbi të gjitha na dhanë besim që të bashkuar do të fitojmë, jo politikisht, por për të fituar patriotikisht se sot është në diskutim çështja e vendit. Duhet të sakrifikojmë çdo gjë, edhe jetën, se çdo prind e jep jetën për të ardhmen e sigurtë të fëmijëve të tij", -tha Kryemadhi.



### Veliat-studentëve: Kthejuni auditoreve, t'i gjeni gati dhomat në tetor

Kryebashkiaku Erion Veliat inspektoi dje punimet për rikonstruksionin e konvikteve tek Universiteti i Mjekësisë. Qendrat studentore kanë pak kohë që kanë kaluar në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe puna ka nisur fillimisht me rikonstruksionin e sallave të leximit dhe bibliotekave. "Se pari, kemi nxjerrë jashtë rezidencës të gjithë zaptuesit politikë, të cilët këtej frymëzojnë protestat, ose mundohen t'i përdorin dhe keqpërdorin ato, dhe këtej gëzojnë të mirat materiale të mjeljes së studentëve. Kështu që, sic e shikoni, kanë dalë jashtë, dhe për të mbajtur edhe atë premtim që i dhashë Këshillit Bashkiak, që nuk pres leksione nga dikush që vetë zaptuan do na flet pastaj për liri studentore. Prandaj, jashtë politikanët, brenda studentët. Ambienti do t'i kthehet studentëve, përfshi edhe kafen dhe gjithë hapësirat e nevojshme për argëtim", deklaroi z.Veliat. Kryebashkiaku u bëri thirrje studentëve t'u rikthehen auditoreve të mësimit për mbylljen në kohë të këtij viti akademik, çka do t'i jepte mundësinë Bashkisë së Tiranës që gjatë muajve të verës, kur ata janë me pushime, të ndërhyjë edhe për rikonstruksionin e dhomave. "Nëse ka ende studentë që për interes dhe për ideal të partisë vazhdojnë dhe protestojnë, do të thotë se shkolla do të shtyhet në gusht-shtator, ndërsa në tetor ata do të duhet të kthehen. Pra, na lë zero hapësirë që të mund të rregullojmë edhe dhomat. Ndaj, u kërkoi studentëve, jo për politikë, por vetëm për interesin e tyre, shkoni në mësim që shkolla të mbarojë kur duhet, në korrik, që ne të kemi mundësi gjatë muajve gusht-shtator të punojmë nëpër dhoma, dhe kur të ktheheni në tetor, t'i gjeni gati", u shpreh z.Veliat. Interesimit të studentëve për "Kartën e Studentit", kryebashkiaku iu përgjigj se me ligjin e ri kjo kompetencë u ka kaluar vetë universiteteve. Gjithsesi, Veliat shprehu gatishmërinë se, nëse drejtuesit e këtyre universiteteve heqin dorë nga kjo përgjegjësi që u takon sipas ligjit, Bashkia e Tiranës është e gatshme që ta realizojë.



**PARALAJMËRIMI**

"Ndal menjëherë dhunën psikike e fizike të tyre. Jepi fund bllokimit të futjes së ushqimit dhe ujit në ambientet universitare ku po zhvillohet protestë europiane. Çdo shtyrje e mëtejshme do shtyjë vendin drejt një konflikti civil me pasojë të paparashikueshme", tha z.Basha.

Kreu i PD: Marku të hetojë skandalet e qeverisë, zyrtarët e PS në vjedhjen e votave

# Basha-Ramës: Mos nxit konflikt civil, gati përballja totale

"Po përgatitet ritenderimi i Unazës"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha i bëri thirrje kryeministrit Edi Rama të ndalë dhunën ndaj studentëve protestues, duke e paralajmëruar atë se çdo veprim tjetër në këtë drejtim do ta shtyjë vendin drejt një konflikti civil. Para gazetarëve, Basha foli në emër të popullit ndërsa paralajmëroi se sjellja e qeverisë po ciklon një konflikt civil në vend. Sipas tij qeveria ka rënë, ndërsa e cilësoi të pa pranueshme ndërhyrjen e policë për të mos lejuar protestën e studentëve në universitetet, i kërkoi prokurorisë të nis hetime. "Ndal menjëherë represionin ndaj studentëve të ngjuar në protestën e tyre të ligjshme në ambientet universitare. Ndal menjëherë dhunën psikike e fizike të tyre. Jepi fund bllokimit të futjes së ushqimit dhe ujit në ambientet universitare ku po zhvillohet protestë europiane. Çdo shtyrje e mëtejshme do shtyjë vendin drejt një konflikti civil me pasojë të paparashikueshme", tha z.Basha. Krahas drejtimin të protestave dhe nxitjes së revoltës popullore për largimin e qeverisë, Basha paralajmëroi se opozita do të zhvillojë dhe betejë brenda institucioneve përfshirë kuvendin. "Beteja do të jetë totale në të gjitha dimensionet protesta do na shohë në në krah dhe në krye të gjithë grupeve qytetare dhe kauzave të tyre, siç kemi bërë në sot", -u shpreh z.Basha.



Kreu i opozitës Lulzim Basha

## Banorët e "Astir" me shkopinë në dorë: Shtëpitë nuk i lëshojmë

Qytetarët e zonës së "Astirit" it dolën dje në ditën e 70 të saj, "te armatosur" me hunjë e shkopinë. Sipas banorëve, kjo "zgjedhje" është një mënyrë demonstrimi rezistence nga ana e tyre, ndaj tentativës për prishjen e baneve të tyre. "Ata që do të afrohen të shtëpitë tona, nuk do të gjejnë të mira", paralajmëroi njëri prej banorëve, ndërsa shpjegoi "armatosjen". Në mbështetje të banorëve ishin sërisht, deputetët e PD-së. "Kush mban përgjegjësi për projektin, dhe për dhunën ndaj banorëve? Kryeprokuroria duhet të japë përgji-



gje për të gjitha aferat korruptive. Shtëpitë tuaja nuk do të prishen, sepse kemi mbështetjen e opozitës dhe të gjithë qytetarëve. Ne do të jemi deri në fund me ju, deri në fitoren e kësaj beteje 70-ditore. Ideatori dhe iniciatori i kësaj afere korruptive

është Edi Rama, ndaj e gjithë fuqia jonë duhet të shkojë në rrëzimin e këtij kryeministri dhe qytetarët të marrin atë që ju takojnë dhe jo t'u jepet oligarkëve pasuria juaj", -u shpreh deputeti i PD-së Klevis Balliu.

kelëse të ligjit. Sot çdo shqiptar e ka të qartë se pse një vit më parë u emëruar Arta Marku. Kjo i vë kapakun pyetjes ku ka përfunduar reforma në drejtësi për Ramën Gjilkunurin e përfutuesit e këtij tenderi korruptiv do të veprojë paketa antimafia", theksoi z.Basha. Dy ditë më parë Neës24 denoncoi hije dyshimi në tenderin e ri për unazën e madhe. Përmes dokumenteve ku shihet se një nga kriteret është kërkesa për kapacitete e mjeteve dhe makinerive që operatorët duhet të disponojnë për të marr pjesë në këtë procedurë. Në piken 13 për

mjetet e punës kërkohet një autovinç me kapacitet mbi 450 ton. **DENONCIMI** Kreu i opozitës denoncoi edhe një tjetër skandal që sipas tij po tentohet të mbyllet nga organi i akuzës; ai për çështjen Bajraj, ku Basha tha se janë konstatuar zyrtarë të lartë shtetërorë dhe socialistë të përfshirë në blerjen e votave. "Edhe ky është rast për të nënvizuar se si është gremisur drejtësia shqiptare që në momentin që Edi Rama ka kapur prokurorinë dhe përmes prokurorëve të kapur po mundohet të ndalë tre he-

time kryesore në shitblerjen e votës: Atë të 20 milionë eurove të Saimir Tahirit dhe të grupit "Habilaj"; Dosjen e famshme "339", ku kanë dalë si maja e ajsbergut deri më sot Vangjush Dako në bashkëpunim me grupin e Avdyllajve; Dosjen e Dibrës, ku Damian Gjilkunuri dhe hierarkë të lartë socialist janë përfshirë drejtpërdrejt në manipulimin, shitblerjen e votës dhe përdorimin e paligjshëm të Policisë së Shtetit në zgjedhjet e shtatorit 2016-të. Dhe tashmë edhe aferën e grupit kriminal të Bajrajve, i cili është kontraktuar, kontaktuar dhe përdorur nga politikanë të lartë socialistë së fundmi në zgjedhjet e vitit 2017-të", u shpreh z.Basha. Po dhe Basha reagoi ashpër duke bërë përgjegjës shtetin dhe institucionet për braktisjen e qytetarëve, të cilët prej ditësh, tha se qëndrojnë të izoluar për shkak të rrugëve të bllokuara nga dëbora.



**Dhuna ndaj studentëve, Berisha: Rama më keq se diktatori i fundit**

Dhunën e ushtruar nga policia mbi studentët, ish-kryeministri Sali Berisha, e quajti si të premtën e zezë që riktheu në Tiranë Prishtinën e vitit 1981. Duke iu referuar ndërhyrjes policore në ambientet e fakulteteve në Tiranë, ku ishin të ngjuar studentët protestues, Berisha, shkruan se "Një akt të tillë të paimagjinueshëm nuk e ndërmoni as dhe diktatori i fundit komunist shqiptar ditët kur studentët po përmbysnin fronin e tij". Ai bëri një krahasim mes dhunës së urdhëruar sipas tij nga Rama dhe Millosheviçit ndaj studentëve të Prishtinës. "Me urdhër antikushetues antiligjor të Edvin Kristaq Urrejtjes dhe mercenariatit të tij Lleshaj, u vërsulen si bisha kundër studentëve grevistë, vajzave dhe djemve që po qëndronin të ngjuar në greve në klasat dhe auditorët e tyre", shkruan Berisha.



**"Vila në Surrel", Çupi: Hetim parave të padeklaruara të Ramës**

PD përmes deputetes Dhurata Çupi kërkoi dje verifikim të pavarur nga ILDKPI për pasurinë e kryeministrit Rama. Sipas Çupit, hetimi do të konfirmonte fshehjen e të ardhurave nga kryeministri dhe vlerën e vërtetë prej të paktën 2 milionë euro të vilës luksoze të Edi Ramës në Surrel. "Mashtrimi me pasurinë dhe ndërtimi i vilës luksoze të Surrelit me qindra milionë lekë të pajustificuara është një nga arsyet kryesore pse Edi Rama refuzoi vettingun e politikanëve. Fshehja e pasurisë është një veprim penalë që dënohet me burg. Pastrimi i parave është një tjetër veprim penalë për të cilën ndëshkohesh po aq gjatë me burg. Prandaj, Edi Rama ka zgjedhur më mirë të heshtë, sesa ta rëndojë edhe më shumë pozitën e tij, duke përfshirë edhe gruan në mashtrimin me pasurinë", tha zi, Çupi.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbarrimore L.D.C

**"Trulli + ndërtesë" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale. 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 3.107.280 Leka.**

Data e shpalljes 20.12.2018  
Data e zhvillimit 15.01.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

**DURRËS** - Tre persona të paidentifikuar dhe me maska në kokë e të veshur me uniformë policie kanë grabitur një biznesmen në Shkozet të Durrësit, ndërsa nga të dhënat e para mësohet se vlera e grabitur është rreth 10 mijë euro. Grabitësit nën presionin e armëve mësohet se kanë lidhur familjarët brenda në shtëpi dhe prej aty kanë marrë sasinë e eurove dhe janë larguar. Në ikje e sipër, grabitësit



**3 agresorët i morën peng djalin dhe më pas e lanë të lirë**

**Maskat lidhin pjesëtarët e familjes së biznesmenit në Shkozet dhe i grabitin 10 mijë euro**

kanë marrë edhe djalin e familjes, por e kanë lanë të lirë disa kilometra më tutje. "Kanë qenë tre persona të armatosur që i kanë zënë pritë tek dera e shtëpisë biznes-

menit të fushës së transportit ndërkombëtar. Fillimisht kanë lidhur të zotin e shtëpisë dhe bashkëshorten, ndërsa njëri prej tre grabitësve ka mbajtur nën pre-

sion djalin e shtëpisë. Po merret në pyetje biznesmeni. Ai ka dalë shtëpitje me djalin për një kafe dhe kur është kthyer ka ndodhur ngjarja", -njoftoi gazetarja nga Durrësi,

Klodjana Haxhijaj. Mënyherë policia ka ngritur pika kontrolli në të gjithë zonën, por ende nuk dihen personat e kësaj ngjarje të rëndë. Edhe pse të terrorizuar, biznesmeni dhe familjarët e tij janë shoqëruar në polici për të dhënë dëshmi rreth kësaj ngjarje. Emri i biznesmenit nuk bëhet me dije ndërsa mësohet se aktiviteti i tij ishte kryesisht në fushën e transportit ndërkombëtar.


Akuzohen për shkelje të rregullave të shërbimit në objektet e rëndësishme dhe vjedhje

**Grabitjet e armëve në Pashaliman, roja: U largova nga vendi i shërbimit se ishte ftohtë**

*Pesë ushtarakë të prangosur për ngjarjen, familjarët: Po i trajtojnë si të ishin kriminelë*

VLORË

Dy ditë pas skandalit për grabitjen e armëve në bazën ushtarake të Pashalimanit, pesë ushtarakë vazhdojnë të mbahen të ndaluar 5 ushtarakë, të cilët akuzohen për "shkelje të rregullave të shërbimit në objektet e rëndësishme" dhe "vjedhje". Mësohet se katër nga personat e vënë nën akuzë janë: 52-vjeçari Lesko Ramosaçaj, 42-vjeçari Edlir Nelaj, 23-vjeçari Ervis Memsulaj dhe 25-vjeçari Ardit Ramaj. Ndërkaq, ditën e djeshme, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar rrëfimin e ushtarakut pranë Policisë Ushtarake në Vlorë, i cili ishte roje mbremjen e së enjtes kur ndodhi ngjarja. Ai tha se kishte lëvizur nga vendi i punës pasi kishte pasur ftohtë, për shkak të temperaturave të ulëta. "Lëviza nga vendi i punës, pasi kisha ftohtë. U largova për të shkuar në një vend me ngrohje", është shprehur ushtaraku. Nga ana tjetër, familjarët pesë ushtarakëve që mbahen të ndaluar janë shprehur të shqetësuar lidhur me ngjarjen në fjalë. Ata kanë deklaruar se të afërmit e tyre po i trajtojnë si kriminelë. "Po i trajtojnë si kriminelë, nuk po na lënë të takojmë të afërmit tanë", pohuan familjarët. Ndërkaq, pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake ka rezultuar se janë vjedhur dy armë automatike, një pushkë, pesë mijë fishekë, dyzet granata dore dhe ndezësa. Dyshohet se autorët të vjedhjes në bazën ushtarake të Pashalimanit janë tre persona. Gjithashtu, dyshohet se autorët janë ndihmuar nga ushtarakë, personel i brendshëm i bazës, të cilët mund t'i kenë informuar për vendndodhjen e armëve në depon që nuk monitorohej nga kamerat e sigurisë, apo duke lënë të lirë vendrojen e saj, çka iu ka hapur rrugën grabitësve. Dyshimet bazohen në faktin se roja i objektit ku u vodhën armët ka braktisur vendin e shërbimit. Ndërkaq, në lidhje me këtë ngjarje reagoi të premtën Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, i cili ka dënuar këtë akt, ndërsa sqaroi se janë proceduar 5 persona për vjedhje dhe shkelje të rregullave të shërbimit. Sipas SHPFA, për këtë rast ka nisur një



Baza ushtarake e Pashalimanit

hetim administrative dhe se do të vihet para përgjegjësisë çdo individ, edhe nëse është pjesë e Forcave të Armatosura.

**REAGIMI I SHPFA**  
Një ngjarje e shëmtuar është regjistruar ditën e djeshme në Bazën Detare të Pashalimanit, ku është dëmtuar një depo armatimi.

Që prej momentit të parë,

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, përmes të gjitha strukturave të tij vartëse dhe në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë, Policinë e Shtetit nisi zbardhjen e shkaqeve të ngjarjes, brenda Bazës së Pashalimanit. Policia Ushtarake referoi dokumentet për ndjekje penale në Prokurorinë e

Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të 5 personave: "Për shkelje të rregullave të shërbimit në objektet e rëndësishme" si dhe u referuan materiale për veprën penale "Vjedhje". Hetimi administrativ i nisur nga SHPFA po vijon dhe po merren të gjitha masat, që çdo person përgjegjës të ndëshkohet për çdo veprim

**RRËFIMI I ROJES**

Ditën e djeshme, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar rrëfimin e ushtarakut pranë Policisë Ushtarake në Vlorë, i cili ishte roje mbremjen e së enjtes kur ndodhi ngjarja. Ai tha se kishte lëvizur nga vendi i punës pasi kishte pasur ftohtë, për shkak të temperaturave të ulëta. "Lëviza nga vendi i punës, pasi kisha ftohtë. U largova për të shkuar në një vend me ngrohje", është shprehur ushtaraku.

**DEKLARATA E FAMILJARËVE**

Familjarët e pesë ushtarakëve që mbahen të ndaluar janë shprehur të shqetësuar lidhur me ngjarjen në fjalë. Ata kanë deklaruar se të afërmit e tyre po i trajtojnë si kriminelë. "Po i trajtojnë si kriminelë, nuk po na lënë të takojmë të afërmit tanë", pohuan familjarët. Ndërkaq, pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake dyshohet se vjedhja e tre armëve automatike që kapin vlerën e 8 mijë eurove në bazën ushtarake të Pashalimanit janë tre persona.

apo mosveprim të tij, sipas ligjeve në fuqi. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dënon aktin por në të njëjtën kohë siguron se, ky rast sporadik, nuk ka dëmtuar sigurinë, gatishmërinë dhe operacionalitetin e Forcës De-


tare. Theksojmë edhe një herë se, papërgjeshmëria e ndonjë individi, qofshin ata efektivë të FA, nuk mund të njollosojë figurën, modelin e përkushtuar dhe sakrificën e efektivëve të Forcës së Armatosur Shqiptare.

**Skandali me shpërblimet e tërmetit të vitit 2018, policia procedon penalisht 7 persona nga Burreli**

**DIBËR** - Policia e Dibrës ka nisur hetimin në gjendje të lirë ndaj 7 personave nga Burreli. Procedimi penal ka nisur pas skandalit të publikuar në "Fiks Fare" në lidhje me shpërblimet e familjeve të prekura nga tërmeti në Bashkinë e Matit. "Specialistët për hetimin e kriminës dhe ekonomik e financiar në D.V.P. Dibër, filluan procedimin penal në gjendje të lirë ndaj 7 sh-

tetasve nga Burreli. Procedimi nisi mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative si dhe bazuar në materialet filmike të transmetuara në emisionin investigativ "Fiks Fare". Këta shtetas dyshohet se duke qenë anëtarë të Komisionit të Verifikimit dhe Komisionit të Vlerësimit në Bashkinë Mat kanë përzgjedhur në mënyrë selektive qytetarët përfitues për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 11 gusht 2018

në Bashkinë Mat. Materialet hetimore do t'i referohen Prokurorisë për hetime të mëtejshme", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Tërmeti i datës 11 gusht 2018 me magnitudë 5.1 të shkallës rihter dëmtoi rreth 400 banesa në rrethin Mat. Bashkia Mat hartoi listat me familjet, të cilat ishin prekur dhe duhet të merrnin një dëmshpërblim, ku nga 400 familje në prefekturë u dërguan për dëmsh-



përblim vetëm 100 prej tyre. Edhe pse në të vërtetë këshilli bashkiak e kundërshtoi listën e përpiluar nga Bash-

kia Mat, kjo e fundit nuk rriti më komision për rivlerësim, duke miratuar listën fillestare.

"La Stampa": Në 2014-ën u dënua me 5.4 vjet burgim dhe 30 mijë euro gjobë

# U ekzekutua në Elbasan, media italiane: Endrit Alibej, i impikuar në trafik droge

## "34-vjeçari shqiptari i quajtur "Tarzan", një kriminel i dyshuar ndërkombëtar

**E**vranë me të shtëna arme zjarri brenda "Range Roverit" të zi, me të cilin po udhëtonte brenda qytetit të tij, Elbasan, në qendër të Shqipërisë. Endrit Alibej, 34 vjeç, nuk pati shpëtim. Së bashku me të, në pritën e disa ditëve më parë u vranë edhe dy miq të tij, të cilët ndodheshin në bordin e së njëjtës makinë luksoze". Kështu nis artikulli i gazetës italiane, "La Stampa" që i referohet vrasjes së trefish të që tronditi Elbasanin, mbrëmjen e 29 dhjetorit të vitit që shkoi. Një vrasje e trefishtë, në të cilën policia shqiptare po heton. Mediat lokale shkruajnë për "sulmet mafioze", duke e cilësuar Endritin si objektiv të vrasësve. Një larje hesapësh e mundshme mes klaneve rivale. Rasti lidhet edhe me prokurorinë e Astit, sepse Alibej në vitin 2013 ishte në qendër të një hetimi maksimal nga ana e karabinierëve të koordinuar nga prokurori publik Maria Vittoria Chiavazza për trafikimin e kokainës midis Holandës dhe zonës së Asti.



Viktima Endrit Alibej

**"TARZANI"**  
Endrit, i lindur në Elbasan më 17 tetor 1984, i quajtur "Tarzan", herë pas here ka përdorur mbiemrin e nënës, Dylgjeri. Por ai, gjithashtu, kishte emërtim të tjerë, të tilla si ai i shtetasit rumun Gabriel Manu ose grek Dimitrios Kriporis. Një kriminel i dyshuar ndërkombëtar që i përkiste një rrjeti evropian droge, për të cilin heqja e kufijve kishte qenë elementi vendimtar për të bërë biznes. Ndërsa është publikuar edhe makina tip "Range Rover" ku udhëtonin viktimat.

### APARTAMENT I "PASTER" NË ASTI

Ai ishte shpërngulur shumë i ri në Asti, dhe deri në vitin 2012 kishte jetuar me të dashurën e tij në një apartament, në zonën e Corso Casale. Endrit Alibej kishte një apartament "të pastër", në një ndërtesë në Via Roreto 13, me qira. Në shkurt të vitit 2012, policia ishte në gjendje të hyjë në shtëpi në Roreto, ndërkohë që askush nuk ishte në shtëpi duke fotografuar drogën dhe fletoren me llogaritjet e organizatës kriminale. Kishte një "konfiskim të vonuar" prej rreth katërqind kokainës. Hetuesit kishin peshuar drogën, të fshehur në një kuti me ushqim, duke i lënë ata në dhomë në mënyrë që të mos rrezikonin hetimin. Në qershor të vitit 2013, u ndërmor operacioni "Cocash", me urdhër të parburgimit të nënshkruar nga magistrati Elena Rocci që kishte qar në arrestime të shumta. Endrit nuk ishte gjetur. Në vitin 2014 ai u dënua në mungesë nga gjyqtari Giacomo Marson në 5 vjet dhe 4 muaj burgim dhe 30 mijë euro gjobë. Gjykimi i konfirmuar



Makina ku qëllua për vdekje 34 vjeçari

### "TARZANI"

Endrit, i lindur në Elbasan më 17 tetor 1984, i quajtur "Tarzan", herë pas here ka përdorur mbiemrin e nënës, Dylgjeri. Por ai, gjithashtu, kishte emërtim të tjerë, të tilla si ai i shtetasit rumun Gabriel Manu ose grek Dimitrios Kriporis. Një kriminel i dyshuar ndërkombëtar që i përkiste një rrjeti evropian droge, për të cilin heqja e kufijve kishte qenë elementi vendimtar për të bërë biznes.

në Gjykatën e Apelit dhe dorëzimi përfundimtar nga Gjykata e Kasacionit më 15 nëntor të fundit.

### EKSTRADIMI

Për Alibejin, procedura e ekstradimit ishte gati të filloje. "Ne kurrë nuk e kemi parë apo dëgjuar atë. Për ne kjo ishte një procedurë e mbyllur", është shprehur avokati i Torinos, Guido Anetrini, i cili e kishte mbrojtur atë në emër të familjes së tij. Ndërkohë, Endriti ishte kthyer në vendin ku gjithçka nisi, në Elbasan, ku gëzonte lirisht pasurinë e akumuluar. Dikush donte që ai të paguante. Atë që ai bëri për të merituar vdekjen do të duhet ta zbulojë prokuroria shqiptare dhe ndoshta, edhe ajo Astigianit.



Shkrimi në mediat italiane

### DËNIMI NË MUNGESË

Në qershor të vitit 2013, u ndërmor operacioni "Cocash", me urdhër të parburgimit të nënshkruar nga magistrati Elena Rocci që kishte qar në arrestime të shumta. Endrit nuk ishte gjetur. Në vitin 2014 ai u dënua në mungesë nga gjyqtari Giacomo Marson në 5 vjet dhe 4 muaj burgim dhe 30 mijë euro gjobë.

## Autorët qëlluan me 18 plumba në drejtim të Alibej

### Masakra e 29 dhjetorit në Elbasan, ja si u vranë në makinë nip e dajë dhe 51-vjeçari turk

**ELBASAN** - Mbrëmjen e 29 dhjetorit, tre persona u ekzekutuan në një atentat mafioz në Elbasan. Ngjarja e rëndë ndodhi mbrëmjen rreth orës 21:15, në rrugën Elbasan-Ish Kombinati Metalurgjik, pranë rrethrotullimit të Bradasheshit. Për pasojë në atentat humbën jetën Endrit Alibej, 34-vjeç dhe Arben Dylgjeri, 56 vjeç, nip e dajë, të dy nga Elbasani si dhe shtetasi Erdal Duranay, 51 vjeç nga Turqia.



Pas ngjarjes, burime nga policia lokale bënë me dije se makina tip "Range Roverit" me ngjyrë të zezë ka marrë 18 plumba në krahun ku ndodhej 34-vjeçari dhe 7 në sediljen e pasme ku gjendej turku. Tre viktimat kishin vetëm pak ditë që kishin ardhur

në Shqipëri. Po ashtu blutë bënë me dije se shtetasi turk jetonte në Rumani, ndërsa Endrit Alibej kishte shumë kohë që nuk ishte kthyer në vendlindjen e tij. Pas kryerjes së hetimeve, hetuesit e çështjes deklaruan se objektivi kryesor i atentatit ka qenë pikërisht 34-vjeçari Endrit Alibej me të shkuar kriminale jashtë Shqipërisë. Po të njëjtat burime u shprehën se atentati dyshohet të ketë ndodhur për larje hesapësh.

**TIRANË** - Fillimi i javës së ardhshme pritet të jetë decisiv për fatin e dosjes hetimore ndaj ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahirit. Grupi i prokurorëve të Krimeve të Rënda që ka në dorë këtë dosje prej më shumë se 16 muajsh do të mbledhet para të mërkurës së 17 janarit, ditë kur përfundojnë afatet hetimit. Hetuesve deri tani u janë dashur të shtynjë afatet e hetimeve 4 herë për shkak të vonesave të përgjigjeve të mbërritura me letër-porosi nga Italia, Greqia e Mali i Zi si dhe hetimit pasuror që po kryhet. Por kjo herë

## Hetimet për ish-ministrin Saimir Tahiri, prokurorët vendosin javën e ardhshme

pritet të jetë e rëndësishme për hetimin edhe për shkak se dosja e grupit të Habilajve u mbyll nga prokuroria dhe u dërgua për gjykim. Prokuroria e Krimeve të Rënda po e heton ish-ministrin e Brendshëm pikërisht për lidhjet me këtë grup, duke ngritur për të akuzat e korrupsionit dhe trafikut të drogës. Sipas akuzës, Tahiri dyshohet se ka favorizuar grupin e Habilajve në trafikun e kanabisit në kohën kur ishte ministër. Por çuditërisht emri i Saimir Tahiri

nuk ishte në listën e 9 personave që u dërguan në gjyq në fillim të kësaj javë, duke veçuar hetimin për të. Por grupi hetimor ka në tavolinë tri opsione se çfarë do të ndodhë me këtë dosje. I pari është zgjatja e afatëve hetimore për shkak se duhet të kryhen edhe disa veprime të tjera. Opsioni i dytë është dërgimi në gjyq i dosjes dhe mundësia e tretë është pushimi i saj për shkak të pamundësisë për të lidhur ish-ministrin me grupin e Habilajve. Saimir

Tahiri për lidhjet me këtë grup u hetua edhe nga autoritetet italiane. Prokuroria e Antimafias së Katanias në 15 Mars të vitit të kaluar i kërkoi gjykatës pushimin e hetimeve ndaj ish-ministrit, pasi nuk gjeti asnjë provë që e lidhte atë me grupin e Habilajve. Kërkesa u miratua nga gjykata dhe ky vendim pushimi është bërë pjesë e dosjes hetimore në Shqipëri, pasi u dorëzua si provë nga vetë Saimir Tahiri.



## TERMS OF REFERENCE

Internship opportunity with UNHCR in Albania

**Organizational Unit:** UNHCR Country Office, Tirana/Programme Unit

**Duty station:** Tirana, Albania

**Type of Contract:** Internship (Full Time)

**Duration:** Three months with possibility of extension

**Expected start date:** 15 February, 2019

**Application deadline:** 25 January, 2019

**Background information/Organizational Context**

UNHCR provides support to asylum seekers and refugees who seek protection in Albania and after receiving status opt for local integration as a durable solution to their situation. UNHCR in Albania operates with different partners among them, local NGOs, UN Agencies and Governmental Institutions to implement its planning on a yearly basis. Implementation of activities is overseen and monitored also by programme unit and as such a series controlling mechanisms for monitoring and reporting are in place.

**Duties and Responsibilities**

- Draft as an initial form the Monitoring of Partners tool kit which contains 7 forms among which the risk assessment and monitoring plan. This kit will be prepared for 5 partners.
- Participate and assist the Assistant Programme officer in verification visits to the partner for MYR.
- Prepare initial draft of the verification reports upon completion of visits
- Draft the audit reports matrix and actions and implementation timeframe for three partners
- Draft documents upon request
- Follow up and monitor the activities of coaching of IRCA partner and report accordingly
- Assist the programme unit in expenditure and other reports for MYR
- Organise seminars and meetings
- Draft and finalise minutes of meetings in programme unit
- Assist programme unit in administrative tasks as required

**Minimum qualifications required**

In order to be considered for the internship, the following criteria must be fulfilled:

- Recently graduated from university or currently enrolled in graduate/undergraduate school at university and completed at least two years of undergraduate studies in Finance and Economics, Public Administration or related field.
- Fluency and good drafting skills in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.
- Strong analytical planning and organizational skills.
- Command use of Excel spreadsheets



## TERMS OF REFERENCE

Internship opportunity with UNHCR in Albania

**Organizational Unit:** UNHCR Country Office, Tirana/Protection Unit

**Duty station:** Tirana, Albania

**Type of Contract:** Internship (Full Time)

**Duration:** Three months with possibility of extension

**Expected start date:** 15 February, 2019

**Application deadline:** 25 January, 2019

**Background information/Organizational Context**

Accession to the European Union will remain the overriding priority of Albanian government, particularly if the negotiations are opened in June 2018. The focus on EU accession provides opportunities for UNHCR to strengthen legislation and procedures in line with international and EU standards. During 2018, the number of arrivals of asylum-seekers/refugees and asylum requests substantially increased as compared with previous years. UNHCR estimates that some 60% of those arriving and requesting asylum are from refugee-producing countries. The Government with UNHCR's and partners' support has expanded reception capacities to cope with the increased mixed movement of persons entering, transiting and requesting asylum in the country. Although the vast majority of those arriving leave the country after a few days, the Government and UNHCR are jointly working to enhance asylum procedures and coordinate efforts to provide solutions for both those willing to enjoy international protection in the country and for vulnerable asylum-seekers. The protection intern will be under the direct supervision of the Protection Associate and will work closely with the multidisciplinary team at the National Reception Centre for Asylum-seekers as well as the Child Protection specialists involved in providing services to children at risk.

**Duties and Responsibilities**

- Facilitate information sessions on asylum procedures at the National Reception Centre for Asylum twice a week.
- Conduct profiling interviews with asylum seekers at the National Reception Centre for Asylum twice a week.
- Support the information management officer with data entry regarding asylum seekers profile and protection incidents reported during the interviews.
- Support the protection team with translation of legal documents, memos, internal reports, notes for the file, and other relevant documents in English and Albanian.
- Provide support with other tasks as may reasonably be required.

**Minimum qualifications required**

In order to be considered for the internship, the following criteria must be fulfilled:

- Recently graduated from university or currently enrolled in graduate/undergraduate school at university and completed at least two years of undergraduate studies in International Law, Political Science or related field.
- Fluency and good drafting skills in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.
- Strong analytical planning and organizational skills.
- Command use of Excel spreadsheets.

**Application and Selection**

Interested candidates are kindly advised to submit CV and motivation letter, as well as certified copies of diplomas or proof of enrolment in graduate or undergraduate studies, by e-mail to [albti@unhcr.org](mailto:albti@unhcr.org). In the subject line please indicate "UNHCR ; V Albania, Protection Internship". Deadline for application: 25 January 2019.

Note: Food and local transportation allowance will be provided to interns who don't receive financial support from an outside part.

An individual whose father, mother, son, daughter, brother or sister is a staff member of UNHCR, including a Temporary Appointment holder or a member of the Affiliate Workforce, is not eligible for an internship with UNHCR.

Only short-listed candidates will be contacted.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS





Kompania "Aleat Safran Group" ka denoncuar 38 raste të vjedhjes së identitetit

I vodhi identitetin, 42-vjeçari fierak, dy herë burg me emrin e vëllait emigrant

Alban Muça u paraqit në gjyq me emrin e vëllait dhe u dënua sikur ishte ai pa u diktuar nga sistemi gjyqësor



TIRANË

Denoncimi i kryer prej kompanisë "Aleat Safran" zbuloi se një 42 vjeçar nga Fieri, i dënua...

Pak vite pasi kishte kryer një dënim 10 vjeçar me akuzat e "mashtimit, falsifikimit dhe përvetësimit të detyrës shtetërore", Alban Muço, një 42-vjeçar nga Fieri...

Por 42 vjeçari e përdori këtë identitet të ri dhe të pastër për të kryer krime të reja. Nga verifikimet e kryera prej Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier rezultoi se ai u dënua dy herë të tjera...

Në të dy rastet, ai u paraqit në gjyq me emrin e të vëllait dhe u dënua sikur ishte ai, pa u diktuar nga sistemi gjyqësor.

Krahimi i këtyre gjurmëve zbuloi se ai aplikimet e bëra në Shqipëri, dy prej të cilave nga burgju dhe Peginitin dhe Drenovës, i përkisnin, në fakt, Alban Muços dhe jo të vëllait L. Muço, i cili ndërkohë kishte aplikuar...

Denoncimi i kryer prej kompanisë "Aleat Safran Group" ka denoncuar se fundmi 38 raste të vjedhjes së identitetit apo të ndryshimit të gjeneraleteve.

Hetimet e kryera nga prokurori i Fierit, Çlirim Sino arritën në përfundimin se Albano Muço vuante dy dënime me emrin e të vëllait emigrant, vetëm pas verifikimit të shenjave të gish-tave.

42-vjeçari, i cili u mor në pyetje në burgun e Drenovës në Korçë, i tha prokurorit se nuk e njohte Albano Muçon [veten], ndërsa mohoi të njohte edhe të vëllanë kur iu paraqiti një fotografi e këtij të fundit.

Muço rezultoi i dënua tre herë për një sërë veprash penale. Sipas dokumentit të lëshuar nga prokuroria, ai ishte dënua fillimisht në vitin 2002 me 10 vjet burg nga Gjykata e Shkallës së parë Fier për veprat penale të "mashtimit, falsifikimit të dokumenteve, përvetësimit të titullit të detyrës shtetërore dhe mbajtjes pa të drejtë të uniformës".



Foto ilustruese

Ai ka dalë nga burgju në vitin 2010 dhe më pas ka aplikuar për t'u pajisur me pasaportë dhe kartë identiteti. Prokurorisë i rezultoi se ai ka bërë disa aplikime. Një aplikim me emrin Albano Muço është refuzuar, pasi ai nuk kishte dorëzuar një kartë të vjetër identiteti. Por në qershor 2015, ai ia ka dalë të marrë një të tillë duke përdorur emrin e të vëllait që jetonte në Itali.

Prokuroria vërtetoi se pasaporta e lëshuar në Fier, në fakt, nuk kishte bërë udhëtime jashtë vendit. Ndërkohë, duke përdorur identitetin e ri, Muço i është rikthyer mashtimit. Duke pretenduar se ishte zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, ai kishte mashtuar tregtarë të ndryshëm dhe dy persona që i kishte punësuar si truporë dhe shofer.

Pretendimi se kishte...

DËNIMET

42-vjeçari, i cili u mor në pyetje në burgun e Drenovës në Korçë, i tha prokurorit se nuk e njohte Albano Muçon [veten], ndërsa mohoi të njohte edhe të vëllanë kur iu paraqiti një fotografi e këtij të fundit. Muço rezultoi i dënua tre herë për një sërë veprash penale.

qenë punonjës në Ministrinë e Drejtësisë ai e ka bërë edhe para prokurorit që e mori në pyetje, ndërsa ndodhesh në qeli në Drenovë i dënua për këtë mashtim. Muço sipas prokurorisë jetoi 6 vjet duke përdorur publikisht emrin e të vëllait.

I denoncuar nga personat që kishte mashtuar, ai u arrestua në vitin 2016 dhe mbajti gjatë hetimit dhe gjykimit emrin që kishte vjedhur. Një sërë artikujsh në media që raportojnë dënimin e tij për mashtim e më pas për kallëzim të rremë, i referohen autorit me emrin L.Muço.

Pas hetimeve ai u dënua dy herë nga gjykata e Tiranës në vitin 2016 "për...

mashtim" dhe një vit më vonë për "kallëzim të rremë". Të dy këto dënime figurorë në emrin e L.Muços dhe jo të Albano Muços.

Por kjo rezultoi vetëm pas verifikimeve të kryera prej prokurorisë së Fierit për të zbuluar "vjedhjen e identitetit". Prokuroria gjeti se aplikimet për pasaportë dhe kartë identiteti me emrin L.Muço ishin bërë nga persona me gjurmë gjurmë të ndryshme.

Krahimi i këtyre gjurmëve zbuloi se ai aplikimet e bëra në Shqipëri, dy prej të cilave nga burgju dhe Peginitin dhe Drenovës, i përkisnin, në fakt, Alban Muços dhe jo të vëllait L.Muço, i cili ndërkohë kishte aplikuar...

për dokumente me emrin e tij në Itali.

Pas këtyre verifikimeve në janar të këtij viti, prokuroria e Fierit regjistroi ndaj 42-vjeçarit procedimin penal me akuzën e "falsifikimit", ndërsa prokurori urdhëron që veprat penale të reregjistruara deri tani në emrin L.Muço t'i atribuohen Albanos.

Ky i fundit nuk ka pranuar akuzat dhe i ka pretenduar se ishte L.Muço, madje i pyetur nga prokurori ka thënë se nuk njohte asnjë person me emrin Albano Muço. Ai ka pretenduar se në vitin 2016 ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Drejtësisë si jurist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun. Madje, ka deklaruar se nuk e njohte personin në foto që kishte bërë aplikimin në Itali, që, në fakt, është vëllai i tij.

Më tej ai ka shtuar se më datë 15 janar 2016 ka bërë kallëzim pranë komisarit të Policisë nr.3 Tiranë për humbjen e dokumenteve të identifikimit, kartë identiteti, pasaportë biometrike dhe të kartës së bankës. Por prokuroria ka verifikuar se një kallëzim i tillë nuk ishte bërë ndonjëherë.

Marrë nga BIRN

Bie intensiteti i reshjeve të dëborës, ja akset problematike

Moti i keq shënon viktimën e dytë në vend, gjendet i vdekur 65-vjeçari nga Korça

Një tjetër person ka humbur jetën, ndërsa dyshohet se shkak është bërë moti i keq. Bëhet fjalë për Vasil Matin, i cili u gjet dje i pajetë në fshatin Çiflig të Korçës nga një banor i zonës. Mendohej se ai po shkonte në këmbë drejt Manastirit të Çifligut ku punonte si roje. Mësohet se bashkëshortja e viktimës kishte nisur të kërkonte për të, pasi nuk i përgjigjej në celular. Mjeko-ligjorët konstatuan se Vasil Mati kishte humbur jetën nga ataku kardiak si pasojë e temperaturave të ulëta. 65-vjeçari është viktima e dytë si pasojë e motit të keq. Javën e kaluar, një tjetër person ishte gjetur i pajetë në rrugë për shkak të kushteve atmosferike. Ndërkaq,

AKSIDENTI NË DURRËS

Një aksident i rëndë me pasojë dy të vdekur ka ndodhur mbrëmë në qytetin e Durrësit, përkatësisht tek rruga e re e ish-Kënetës në lagjen nr.17. Mësohet se viktimat janë dy gra dhe konkretisht Bukurie Cufaj 56 vjeçe dhe Sabije Cufaj 38 vjeçe. Sabija është nusja e djalit të viktimës tjetër. Sipas bluve, ato janë përplasar pranë një karburanti nga një automjet tip "BMW" që drejtohej nga një 22-vjeçar, i cili është ndaluar.

reshjet e dëborës e kanë ulur intensitetin. Akset kryesore rrugore të vendit janë të kalueshme. Por në zona të thella malore, dëborë po i mban të bllokuara rrugët e disa fshatrave. Në Jug, lëvizja e makinave bëhet pa zinxhir. Ndërsa në Veri ka probleme në disa rrugë të Kukësit e Dibrës. Sipas ARRSH-së, aksi Kukësit-Bushtricë kalohet pjesërisht

me zinxhir, ndërsa Domaj-Draj Reç vetëm me zinxhir. Në Dibër zinxhirët janë të domosdoshëm në rrugët Kuben-Vasije, Peshkopi-Qafë Drajë, Ura Cerencit-Steblevë, Qafë Buall-Krastë, Burrel-Komsi dhe Bulqizë-Fushë Bulqizë, ku erëra të forta e grumbullojnë borën në rrugë. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, që ishte në këtë rajon ga-



ranto monitorim të të gjitha rrugëve dhe të kompanive që janë kontraktuar për mirëmbajtjen e tyre. Në Elbasan, në rrugën Librazhd-Steblevë rekomandohet përdorimi i zinxhirëve pasi në vendin e quajtur Shkalla e Lunikut, ku ka akull në trashësi të konsiderueshme. Në njësinë administrative Orenjë, ekipet e OSHEE-së janë shpërndarë në terren për të riparuar mëmë e shkaktoara nga moti. Shtabi i Emergjencave i erdhi në ndihmë një emergjencë

mjekësore në fshatin Dorës. Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu ishte në Komsi të Burrelit, ku garantoi gatishmërinë e stafit mjekësor për t'u përgjigjur nevojave të qytetareve në këto dite të vështira. Në Krutë, tre fshatra të malësisë janë të bllokuara. Në Parkun Kombëtar të Qafë Shtamës duhen përdorur zinxhirët. Herë pas here këto zona kanë probleme me energjinë elektrike, pasi demtohen linjat elektrike nga erërat e forta.

## PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET NË 2019-ËN

Vendimi: Aplikimi për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 01.01.2018 e në vazhdim

# Pensionet e pleqërisë, sa do të jenë koeficientët e rinj në 2019-ën

*ISSH do të rillogarisë masën e pensioneve, kategoritë që preken*

Voltiza Duro

Që prej një janarit të këtij viti, janë futur në fuqi koeficientët e rinj të indeksimit të pagave, në bazë të së cilëve do të llogariten pensionet për të gjithë ata që përmbushin kriteret e përcaktuara. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot tabelën me koeficientët që do të përllogaritin masën e pensionit për 2019-ën. Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, i propozuar fillimisht nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficient më të ulët. Kështu pensionet që janë lidhur e që do të lidhen në vazhdim do të shumëzohen me koeficientin 8,76. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001. Ky vendim vlen edhe për vitin 2019-të, ku koeficienti do të jetë 1,00, njësoj si në 2018-ën. Ndërkohë pagat nuk mund të jenë më të larta se paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që cak-



### FORMULA

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë.

### VENDIMI

Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficient më të ulët.

### KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë.

tohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", nënvizohet në vendimin e qeverisë.

### KOEFICIENTËT

"Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave që koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë

paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si në tabelë", theksohet në vendim. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e

pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë. Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indeksat e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një



### KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Për pagat referuese deri më 1.1.1994 8,76;

Për pagat e vitit 1994	8,76;
Për pagat e vitit 1995	7,05;
Për pagat e vitit 1996	5,47;
Për pagat e vitit 1997	5,47;
Për pagat e vitit 1998	4,57;
Për pagat e vitit 1999	3,71;
Për pagat e vitit 2000	3,38;
Për pagat e vitit 2001	2,89;
Për pagat e vitit 2002	2,67;
Për pagat e vitit 2003	2,39;
Për pagat e vitit 2004	2,17;
Për pagat e vitit 2005	1,97;
Për pagat e vitit 2006	1,79;
Për pagat e vitit 2007	1,71;
Për pagat e vitit 2008	1,51;
Për pagat e vitit 2009	1,39;
Për pagat e vitit 2010	1,33;
Për pagat e vitit 2011	1,28;
Për pagat e vitit 2012	1,23;
Për pagat e vitit 2013	1,18;
Për pagat e vitit 2014	1,18;
Për pagat e vitit 2015	1,02;
Për pagat e vitit 2016	1,02;
Për pagat e vitit 2017	1,00;
Për pagat e vitit 2018	1,00;
Për pagat e vitit 2019	1,00

koeficient. Edhe ky indeks është i përkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientë respektivë.

### LLOGARITJA

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur

rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit.



Voltiza Duro

**P**ër të përfutur pension pleqërie individit duhet të bazohet te kriteret, mosha dhe vitet e punës me kontribute. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot dokumentacionin që duhet të dorëzojnë të interesuarit që dëshirojnë ta përfutur këtë pagesë. Domoshmërisht individit duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 10 muaj për gratë e mbi 65 për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit, e në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individit mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individit ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individit humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepet të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individit ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore, janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vlash apo dublikatë librezë. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me siguri ka një "ngërc" e men-

**DOKUMENTACION I PASAKTË**

Librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vlash apo dublikatë librezë. Punonjësit e ISSH-së duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

**LISTEPAGESAT**

Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individit ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individit humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute.

Shembujt konkretë bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagat referuese

# Si do të përlogaritet masa e pensionit të pleqërisë për 2019-ën

*Kriteret dhe dokumentacioni që duhen plotësuar*



**PERLLOGARITJA**

Formula e përlogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75' kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar.

**KRITERET DHE LLOGARITJA**

**Kushtet**

Të gjithë ata persona që kanë plotësuar moshën dhe kanë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfutur pension pleqërie.

Përkatësisht burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, Gratë mbi 60 vjeç e 10 muaj në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese.

**Llogaritja**

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18 i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet si më poshtë:

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social.
3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 ( i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 ).
4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social."

Për ta pasur sa më të qartë këtë përlogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social.

Sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfutur nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

**Formula**

PP (Pension i Pleqërisë) = PS (Pension Social)\* (shumëzuar) me vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) me vite sigurimi\* (shumëzuar) me BV (baza e vlerësuar).

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

jëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

**FORMULA E LLOGARITJES**

Formula e përlogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75' kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e

bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhëve të sigurimit, si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe periudhëve të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.



NGA LUAN RAMA\*

**H**istoria e vjetër e shqiptarëve gjithnjë e më shumë na zbulon bëma e ngjarje të habitshme, ku jo rrallë, shqiptarët janë protagonistë dhe aktorë vendimtarë të ngjarjeve të mëdha jashtë territoreve shqiptare. Dhe kur këto bëma, këta emra kalorësish dhe politikanësh të shquar, i ndesh në faqe librash mesjetarë, të ngjan se në hirin e kohërave zbulon gurë të shndritshëm, sikur ato prushe të jenë fshehur ashtu, për të mos u shuar kurrë. Të tillë ishin stratotët e famshëm shqiptarë, këta kalorës të ngjeshur me hekur, që për afro një shekull e gjysmë, konsideroheshin kalorësia më e lavdishme e kristianizmit evropian.

Emri i stratotëve vjen nga greqishtja «stratiotes» që do të thotë luftëtar, e përdorur nga shqiptarët e Moresë. Venecianët ata i quanin ata «stradioti». Stratotët u shfaqën në histori pas epokës së lavdishme të Skënderbeut. Ishte koha kur hordhitë osmane filluan të dyndeshin drejt Ballkanit perëndimor për të dalë në Adriatik dhe për të shkuar gjer ne brigjet veriore të Mesdheut. Philippe de Comynes, (1447-1511) diplomat mjaft i njohur në Evropë dhe këshilltar i mbretit të Francës, në kujtimet e tij *Memoires*, shkruan për famën e stratotëve, duke na kujtuar dhe fjalorin e hershëm *Thresor de la langue Françoise*. «Ata ishin shqiptarë nga Durrësi dhe shqiptaro-grekë që vinin nga Morea, që në atë kohë dhe ajo ishte nën zotërimin e venedikasve». Comynes i kishte parë ata në Venecie kur 1500 stratotët kishin zbrakuar në ishull, ku kishin bërë një paradë madhështore, pranë abacisë Saint-Nicolas. Atëherë stratotët identifikoheshin me termin «Cavalerie Albanoise» dhe Perëndimi kishte shumë nevojë për ta, pasi shpesh ishte kavaleria ajo që vendoste fatin e betejave të mëdha. Ata ishin



## Stratotët shqiptarë, mercenarët e frikshëm të Europës

«Ata vinin mbi kuaj sikur t'i sillte stuhija»,  
Jean Marot, historian i Mesjetës

luftëtarë të armatosur gjer në dhëmbë, me kostume hekuri dhe

me mansheta të gjata prej rrjete çeliku, që mbanin një heshtë me dy

maja, të gjatë 3 metra, të cilën e manovronin me të dyja duart dhe

që luftonin mbi kuaj gjithnjë në këmbë. Heshta e tyre quhej «zagayé», që nuk është çudi të jetë një fjalë e vjetër shqipe. Ata cilësoheshin «luftëtarë të tmerrshëm», siç i përshkruajnë kronistët e kohës dhe flinin jashtë, në natyrë, bashkë me kuajt e tyre.

Stratotët ishin në fakt një trupë mercenarësh, por tepër të krishterë dhe nuk dyshohet që në luftën kundër turqve, ky element të ketë luajtur një rol të dorës së parë. Të detyruar të braktisnin trojet e tyre, në fillim, ata luftuan në krah Venedikut kundër ushtrive të mbretit të Francës, ku siç shkruhet në tekstet e vjetra historike, «për çdo kokë francezi, ata paguheshin 1 dukat». Megjithatë ata i shërbyen dhe republikave të tjera të veriut të Italisë apo Napolit.

→ Vijnë në faqen 14

# K

## KUJTESË

Emri i stratiotëve vjen nga greqishtja "stratiotes" që do të thotë luftëtar, e përdorur nga shqiptarët e Moresë. Venecianët ata i quanin ata "stradioti". Stratiotët u shfaqën në histori pas epokës së lavdishme të Skënderbeut. Ishte koha kur hordhitë osmane filluan të dyndeshin drejt Ballkanit perëndimor për të dalë në Adriatik dhe për të shkuar gjer ne brigjet veriore të Mesdheut...

# Stratiotët shqiptarë, mercenarët e frikshëm të Europës

"Ata vinin mbi kuaj sikur t'i silte stuhija", Jean Marot, historian i Mesjetës

NGA LUAN RAMA\*

Vijon nga faqja 13

Sidoqoftë, më pas, lidhja me mbretërit francezë do të jetë e qëndrueshme përgjatë më shumë se një shekulli. Mbreti i Francës Henri II e forcoi kavalerinë e tij duke thirrur në ushtrinë franceze një numur të madh stratiotësh. Kavaleria e tij quhej atë kohë "Argoulets", ndërsa stratiotët, francezët i quanin herë "Albanais" dhe herë "Estradioti". Në fakt, stratiotët do angazhoheshin edhe nën mbretërinë e Louis XII, i cili mori 2000 stratiotë të veshur shqiptarë, apo "à l'albanoise", siç shkruajnë kronistët francezë. Në shënimet e tij të udhëtimit Jean Marot, poet dhe sekretari personal i mbretit francez, shkruante se "ata vinin mbi kuaj sikur ti silte stuhija". Në shekullin e XVI tri kavaleri ishin më me emër në gjithë Evropën: së pari stratiotët shqiptarë, së dyti kalorësit spanjollë "genetiares" dhe së treti kalorësit gjermanë "reitres". Madje në atë kohë, në Francë përdorej dhe shprehja "chevaucher comme un Albanais" ("të kalërosh si një shqiptar"). Edhe mbreti tjetër i Francës, François I, një nga mbretërit më progresist të Francës, futi në ushtrinë e tij shumë kalorës stratiotë. I biri i tij, i kishte afruar ata gjer në truprojen e tij, ndërsa Henri IV dhe Louis XIII i kishin në përbërje të ushtrive të tyre. Po kështu dhe Henri I dhe Montmorency, një nga dukët dhe marshallët e njohur të Francës, truprojen e tij e kishte vetëm me shqiptarë. Sipas Ch. Hopt, në librin e tij Chroniques greco-romaines, shkruhet për të birin e Gjon Muzakës, Adrianin, i cili ishte kapiten i kalorësisë së lehtë në shërbim të mbretit francez. Ai kishte nën komandën e tij një trupë prej 200 stratiotësh dhe me ta luftoi kundër anglezëve të veri të Francës. Por më pas mësohet se i helmuar ai vdiq në Picardie, në vitin 1526. Por ndërkohë, vëllai i tij, i quajtur Konstantin, siç shkruan historiani Paolo Petta në librin e tij Despotë të Epirit dhe të Maqedonisë, (Despoti d'Épire e principi di Macedonia), ishte nga të pakët komandantë që e shpëtoi trupën e tij dhe në krye të tyre mori rrugët drejt Francës. Edhe Merkur Bua njëjshi si një stratiot i famshëm, i cili do të merrte dhe gradën gjeneral i kavalërisë franceze të Louis XII. Madje në dokumentet veneciane, ai cilësohej "magnifico conte Mercuri Bua". Kronikanët italianë shkruajnë për ndihmën e madhe që i dha princit Malatesta Baglioni-t në luftën kundër spanjollëve, duke marshuar së bashku drejt Veronës, për ta çliruar atë. Historiani Jean-Claude Faverey, në studimin e tij Historia e Shqipërisë, duke shkruar për lidhjet e vjetra mes francezëve dhe shqiptarëve, thekson se "Në kohën e Louis XIII, misionarët francezë që vizituan Shqipërinë, u habitën kur panë me

1 Stradiot, ca. 1500  
2 këchter venezianischer Reiter, ca. 1500  
3 Griechischer Edelmann, frühes 15. Jahrhundert



admirim këtë racë me shpirt të fuqishëm, shtatllatë, me tipare të ashpra dhe me armët ku ishin emblemat e zambakut francez". Pikërisht, në kulmin e lavdisë së stratiotëve spikat dhe figura e një prijësi të madh të tyre, Konstantin Araniti.

### ARANITI, ALEATI I MBRETIT FRANCEZ

Konstantin Araniti është një nga personazhet më të habitshëm të historisë shqiptare pas epokës së Skënderbeut. Ai ishte nga të rrallët që arriti një dimension evropian në orrorret mbretërore të republikave të veriut të Italisë, të mbretërisë së Francës apo të Napolit në Italinë e jugut, etj. Mjerrsiht historiografia shqiptare shumë pak e ka prekur këtë figurë që ka simpatike dhe të besës, por dhe një person tek i cili, mbreti i Francës dhe mbretërit e tjerë të jugut dhe të veriut të Italisë, kishin nevojë të mbështeteshin. Shumë historianë italianë dhe francezë, kur kanë shkruar për historinë e luftërave të Italisë apo mbi historinë e mbretit francez Charles VIII, janë ndalur dhe tek figura e këtij personazhi të quajtur shpesh : Konstantin Araniti. Siç ka shkruar dhe historiani

### Fama e tyre

Philippe de Commines, (1447-1511) diplomat mjaft i njohur në Evropë dhe këshilltar i mbretit të Francës, në kujtimet e tij Memoires, shkruan për famën e stratiotëve, duke na kujtuar dhe fjalorin e hershëm Thesour de la langue Française. "Ata ishin shqiptarë nga Duras (Durrësi) dhe shqiptaro-grekë që vinin nga Morea, që në atë kohë dhe ajo ishte nën zotërimin e venedikasve".

francez Commines, i cili e ka njohur nga afër, Konstantini kishte lindur në 1456 në Durrës dhe ishte biri i Gjergj Aranitit, një feudali shqiptar të njohur në luftat kundër otomanëve. Një nga vëllezërit e tij, Vladan Araniti, ishte martuar me një nga motrat e Skënderbeut, ndërsa vetë Skënderbeu ishte martuar me motrën e tij Donika Araniti. "Nëna e Konstantin Aranitit ishte Petrina Francone nga Pulja, vajza e madhe e baronit të Taurisanos, Oliviero Francone, një lietnant aragonesh nga Leçe. Gjergj Araniti, shkruan diplomati francez, vdiq në Durrës dhe la tri djem, të cilët më 1464 u njohën si "patricë venecianë". Madje Konstantini hyri në shërbimin pontifikal (tek Papa) dhe arriti një funksion si "proto-noter apostolik". Në fund të viti 1486 Konstantini shkoi në shërbim të mbesës së tij, Maria e Serbisë, e lindur me mbiemrin Branković dhe që ishte gruaja e markezit Boniface të Montferratit të Italisë. Por si trashëgim nga të parët e tij, ai kishte dhe titullin "comte de Macedoine dhe duk i Acaia (Greqisë së veriut)".

Më 1495, Commines, është i dërguari i mbretit të Francës në Venecie. Shënimet e këtij ambas-

dori dhe historiani janë tepër interesante, si për atmosferën dhe gjendjen e Shqipërisë në atë kohë, ashtu dhe për Aranitin dhe luftën e stratiotëve. Në fakt, mbreti Charles VIII rridhte nga familja e anzhuinëve (më 1272, Charles I d'Anjou ishte mbret i Napolit dhe i Shqipërisë) dhe pas kurorëzimit si mbret i Francës, ai duhej të shkonte dhe në Napoli të merrte kurorën si mbret edhe i mbretërisë së Napolit. Në Casale, në veri të Italisë, më 7-10 tetor 1494, ai u takua me prijësin shqiptar Konstantin Araniti dhe mbesën e tij, Maria e Serbisë. Me Aranitin, ai bisedoi për fillimin e një betejeje në front të gjerë kundër turqve. Madje siç shkruajnë kronikanët, mbreti kishte parë në ëndërr një flamur kryqëzate, çka nënkuptonte për të se duhej të shpëronte varrin e Krishtit në Jeruzalem. Në Casale, Araniti e shtyu mbretin francez të ndërmerre një kryqëzate të vërtetë kundër otomanëve dhe për këtë i premtoi kontributin e dhjetra mijra stratiotëve dhe këmbësorëve të tjerë që prisnin në brigjet e Adriatikut, në tokat shqiptare. Sigurisht, qëllimi i Aranitit ishte çlirimi i Shqipërisë dhe rikthimi në trojet e veta. Siç na informon Commines, në një manifest të 22 nëntorit të vitit 1494, i cili u shtyp dhe u shpërnda në Firence, Charles VIII për herë të parë bëri të njohur projektin e tij për të zbraktuar në Vlorë, në bregun shqiptar. Plani i tij ishte shumë ambicioz : të thyejë turqit dhe të vendosë perandorinë bizantine. Dhe në këtë projekt ai kishte dhe mbështetjen e Vatikanit. Megjithatë do të shkonte në Napoli për kurorëzimin, ai vendosi të dërgonte në Vlorë 6 mijë ushtarë me në krye Antoine de Ville, sire de Domjulien. Më 27 janar 1495, u nënshkrua traktati i aleancës midis Charles VIII dhe Papës, ndërkohë që Commines fshihte në ambasadën e tij në Venecie Konstantin Aranitin, i cili ishte me mision sekret: përgatitjen e revoltës me ndihmën e Francës.

Nga Venecia, siç na informon historiani francez Joël Blanchard, i cili i referohet Commines shkruaht se: "Mijra kristianë janë gati të revoltohen. Nga Otranto në Vlorë janë veçse 60 milje dhe nga Vlorë në Kostantinopojë janë 18 ditë udhë me këmbë, në një rrugë ku ka veçse 2-3 kështjella, pasi të tjerat janë rënuar. Gjithë këto vënde me shqiptarë, sllavë dhe grekë i merrnin lajmet e mbretit nga miqtë e tyre që ishin në Venecie apo në Pulje dhe që prisnin veçse "mesinë" që të ngriheshin në këmbë. Arqipeshkvi i Durrësit është shqiptar. Ai më ka folur për një numër të jashtëzakonshëm shqiptarësh, të gatshëm që të bashkohen në luftë dhe që janë bijtë e nipat e shumë senjorëve si të Skënderbeut, një bir i Konstantinopojës, apo nipa të senjor Konstantinit, që sot qeveris në Montferrat. Midis jeniçerëve më shumë se 5 mijë prej tyre i kanë lënë rradhët turke. Shkodra e Kruija janë marrë në sajë të punës së Konstan-



B

BOTIM

Poezitë e këtij autori të shquar, mes të shquarve të tjerë të poezisë polake të shekullit XX, vijnë për herë të parë për lexuesin shqiptar nga "Botimet POETIKA" si fryt i bashkëpunimit me dy përkthyes të njohur dhe me mbështetjen e Institutit Polak të Librit dhe të Ambasadës së Polonisë në Tiranë...

# Tadeusz Różewicz: Poeti që shkroi në prag të heshtjes

NGA DR. SILVANA LEKA

**T**adeusz Ruzeviç i përket dhe ishte pjesë rëndësishme e më të shquarve poetë-dëshmitarë të Europës, që u shfaqën pas Luftës së Dytë Botërore, pikërisht në gjysmën më pak me dritë të shekullit XX-të, por që shkruan për anën më tronditëse të asaj periudhe, përfshi këtu edhe produktin më makabër, që njeriu prodhoi gjatë atij shekulli.

Nuk ishte periudha në të cilën jetoi dhe as jetëgjatësia e tij aspekti kryesor që ky të bëhej një nga zërat më të fuqishëm të atij brezi të mashruar dhe të zhgënyer. Ishte talenti i jashtëzakonshëm, qëndresa dhe vetëpërmbytja për të mos i zgjedhur me kujdes të veçantë manierist fjalët, për t'i mbajtur nën kontroll metaforat dhe për të qenë pro estetikës së ashpër të së vërtetës së hidhur.

Ai ishte nga poetët e fundit të atij brezi që njohu dhe shkroi për luftën dhe për Europën që në vend që të punonte më fort kundër humbjes së kujtesës, zgjodhi të ngulte gozhdën e fundit mbi kujtesën historike.

Tadeusz Ruzeviç, i cili u nda nga jeta më 2014-ën, i përket brezit të parë të shkrimtarëve polakë të lindur, pasi Polonia rifitoi pavarësinë, në vitin 1918. Ai mbetet një nga vjuesit më të rëndësishëm të poezisë madhështore polake të shekullit 20-të dhe ndjekës i denjë i rrjedhave letrare ndërkombëtare të avantgardës.

Emri i tij përmendet shpesh si kandidat për Çmimin Nobel. E nisi krijimtarinë nga viti 1944, duke krijuar 15 vëllime shumë të njohura e të vlerësuara me poezi, të përkthyer në 50 gjuhë të botës. "Ai solli një formë të re poetike dhe ishte gjithashtu mjaft novator në dramaturgi, duke rindërtuar ndjenja e kuptime të tjera mbi jetën në përfundim të tragjedisë së Aushvicit.

Sipas Theodor Adorno-s, pas kësaj traume të kryer nga njeriu, zor se kishte më vend për ndjenja delikate, përmendjen vend e pavend të fjalës "humanizëm" dhe thaujese pamundësi për të shkruar ndonjë gjë autentike".

Tadeusz Ruzeviç është lloji i poetit që nuk vajton dhe nuk derdh lot, por drithërohet si letër gazete, por jo në trajtësisht. Pjesë e kolazheve të tij në poezi dhe në dramë e mirënjohura, janë gjithçka intime dhe publike që ndodh, të parëndësishme në dukje, si kartolinat, një hartë, emra rrugësh e hotelesh, por që marrin rëndësi në penën e tij që gjen formën më shprehëse të poezitë mbi çnjerëzimin, që kulmon me holokaustin dhe përndjekjet.

Nuk duhet të ketë qenë e lehtë për një autor që njohu luftën e zjarrit dhe luftën e Ftohtë, nënshkrimin e armëpushimit, paqen, superfuqitë, stalinizmin, ngritjen, shembjen e Murit të Berlinit dhe

"rënien e lotëve në bursë", siç e ndeshim në një nga poemat e vona të Ruzeviç-it.

Poezitë e këtij autori të shquar, mes të shquarve të tjerë të poezisë polake të shekullit XX, vijnë për herë të parë për lexuesin shqiptar nga "Botimet POETIKA" si fryt i bashkëpunimit me përkthyesit Astrit Beqiraj e Ben Andoni dhe me mbështetjen e Institutit Polak të Librit dhe të Ambasadës së Polonisë në Tiranë.

Përveç poezive, të qëmtuara me kujdes dhe që përfaqësojnë faza të ndryshme të krijimtarisë së këtij autori, botimi "Tadeusz Ruzeviç - Përmbledhje poezish" shoqërohet edhe nga dy tekste që vihen në ndi-

## Për Tadeusz Ruzeviç

Tadeusz Różewicz është lloji i poetit që nuk vajton dhe nuk derdh lot, por drithërohet si letër gazete, por jo në trajtësisht. Pjesë e kolazheve të tij në poezi dhe në dramë e mirënjohura, janë gjithçka intime dhe publike që ndodh, të parëndësishme në dukje, si kartolinat, një hartë, emra rrugësh e hotelesh, por që marrin rëndësi në penën e tij që gjen formën më shprehëse të poezitë mbi çnjerëzimin, që kulmon me holokaustin dhe përndjekjet.

hmë të lexuesit për të komunikuar më mirë me krijimtarinë dhe për të pasur në duar disa celësa, pa të cilët zor se mund të hysh brenda poezisë së njerit prej poetëve emblematikë për shekullin e 20-të.

Jo rastësisht teksti poetik i Ruzeviç-it është vendosur mes dy rekomandimesh në prozë. Teksti i parë, që shërben edhe si ftesë hyrëse universin plot vrime të zeza të këto autorit, është eseja, "Fshehur në vetvete: poezia e R?zewicz-it", me autor Tom Paulin.

Teksti i dytë, me autor John Osborne, përmes esesë me titull "Tadeusz Ruzeviç: Gërsheti", përdor një poezi të vetme si pishtar për të ndiqur pak më shumë aktin vetmitar të leximit nëpër labirintin e krijimtarisë së R?zewicz-it dhe të autorëve të tjerë të së njëjtës qasje dhe të së njëjtin këndvështrim në poezi.

"Këta njerëz dhe unë, shkruan R?zewicz-i, e mësuam gjuhën nga mbishkrimet mbi mure." Por ajo çka kam krijuar, ngulmon të gënjësojë ky autor; nuk është vetëm poezi, por edhe figura e poetit që shkruan për të humburit nga tmërr. "Për ata që janë shpënë në kasaphanë. Për ata që mbijetuan", do të shkruante vetë Ruzeviç kur u shpreh për poezinë e tij.

Në poezinë e Ruzeviç-it gjenden,



vetëm mes koncepteve religjioze, motivet e së cilave gjenden dendur në krijimtarinë e hershme të Ruzeviç-it, por edhe midis humanes dhe çnjerëzores së krijuar nga vetë njeriu.

Si poet Ruzeviç-i u rreshtua me ata që shpërfillnin atë çka pjesa më e madhe e njerëzve e mendonin si "poetike". Ai zgjodhi gjuhë të thjeshtë dhe një teknikë të gjërë moderniste për të kërkuar imazhet e përfundimeve më të errëta.

Në këtë kontekst, poezia "tepër të thjeshtë", e Tadeusz Ruzeviç-it ka stil prej asketi, me mënyra shprehëse që mund ta kuptojë edhe femija. Tekstura e zërit nuk ishte fort ndryshe nga ato që gjejmë edhe tek poetë të tjerë të brezit të tij, Zbigniew Herbert, i njohur për të ashtuquajturën "disidencë estetike" apo dy qendrat e tjera të poezisë polake Czesław Miłosz dhe Wisława Szymborska. Poezia e këtij brezi i kishte shpallur luftë retorikës patetike, duke artikuluar atë mënyrë ligjërimi që kuptohej mes rreshtash.

Ndërsa Herbert-i cilësohet si poet anti regjimit, por i sofistikuar, vargjet e të cilit, sidomos me Zotin Cogito, nuk dalin haptazi kundër dogmave e klisheve politike, te Ruzeviç-i gjuha poetike është publike, e pamëshirshme dhe e drejtë-perdrejtë, ndonëse vargjet e tij janë plot dhimbje. Gjuha e poezive të Tadeusz Ruzeviç-it përputhet me personalitetin e shpërbërë njerëzor, me gjendjen e njeriut të çliruar, por të humbur mes botës formale e të zvetënuar.

Këto tipare vihen re sidomos në poezitë ku ka një grup apo një fëmijë, "të vetmit banorë qiellorë mbi tokë", siç quan poeti të "Regio" apo fëmijët e mëvonshëm, "lindur pa dhimbje në klinika, pjekur në diskoteka çjerrë nga drita artificiale dhe tingujt me gojë hapur para ekraneve TV, që nuk dinë të bisedojnë me pemët", siç përshkruhen të Prerja e drurit.

Kulm i padyshimtë i krijimtarisë së tij është poezia "Gërsheti":


Pasi të gjithë ngarkesës së grave ia rruan kokat katër të ngarkuar me fshesa degë mëshëtknash pastrojne dhe mbledhin tok flokët Pas xhamave të pastër dergjen flokët e kufomave të mbytur në dhomat e gazit në këtë floknajë plot gjilpëra me kokë dhe krehra Floku nuk goditet përmes dritës së mund lëviz dot prej puhisë s'mund ta prekë ndonjë dorë as shiu apo buzët Brenda gjokseve të mëdha retë e flokëve të thatë të atyre që u mbytën qëndron një gërshet i venitur

sobës pas gjashtë ditësh punë dhe vëllai, të cilit i dërgon një kartolinë me ujvarë.

Por më dukshëm elementet biografikë shpalosen në formë rrëfimi të "Nëna niset". Ky tekst ndërtohet si ditar, pjesë e të cilave janë kujtimet, copëza bisedash të kapura në ecje dhe diku edhe disa vargje nga ajo që quajmë poezi. Tekst shfaq para lexuesit pamjet e konvertimit. Një fëmijë me nënë thellësisht fetare, e lindur hebreje në besim, që bëhet pjesë e komunitetit katolik.

Mbi të gjitha këto rri figura e Zotit të plotfuqishëm, që nuk qesh, që "përzien hidhësinë me ëmbëlsinë" dhe që "i pikturoar aq keq, rri varur pa shpresë mbi mur", siç e shohim në poezinë "Gështenja.

Me fjalë të kursyera vijnë fakte që, përtej përgjithësimin, mund të trajtohen edhe si vargje autobiografike mbi jetën jashtë mjediseve urbane të familjes së poetit. Prej atyre ai mësoi se e Keqja ekziston njëjloj si e Mira dhe se individit jeton jo



mes të tjerash, edhe shumë detaje autobiografike. Aty shfaqet nëna "aq e vockël sa mund ta mbaje ndër duar", e qetë, ndoshta e lodhur, që e thërret nga dritarja të kthehet në shtëpi, babai, që "mbjell gështenja ballë shtëpisë" e që dremit ndanë





A

ARGUMENT

NGA VLASH PRIFTI\*

Ti japësh një ide, ta jetosh një objekt të materializuar, do të thotë, ta kthesh atë (ta jetë sosh) në krijim, që do të thotë; të ndërftosh një objekt në një skenar të ri. Gjithashtu, bashkëgjatur saj, mund të shtoj se mungesa e dëshirës për tu përqendruar e për tu startuar me esencën, e cila përbën një problem për ditët e sotme, në të kundërt në krijimtarinë e krijuesit Kristo Krisiko, nuk gjen strehë. Përkundrazi ajo është bërë leitmotivi në krijimtarinë e këtij autori.

Një vepër arti, thotë artisti i njohur Henry Moore, duhet në fillim të ketë vitalitetin e vet. Unë nuk dua të them (thotë ai) një pasqyrim të vitalitetit të jetës, të lëvizjes, një veprim fizik por një vepër, një krijim që të ketë brenda saj, një energji të ndrydhur të brendshme, një jetë intense të vetën, independente nga objektet që ai paraqet. Kur vepër ka këtë vitalitet të sajën të fuqishëm, ne nuk e lidhim fjalën "e bukur" me të. Ky mendoj unë, ka qenë edhe qëllimi që objektet metalike të ekspozuara jashtë në hapësirën e vulltshme përpara galerisë tashmë të njohur FAB, të na surprizojnë me thjeshtësinë e formës dhe forcën e ekspresionit.

Një tjetër kërkesë mjaft e rëndësishme për këtë krijues, është që vepër e tij, ashtu si ato të mjaft artistëve bashkohës, të japë kënaqësi, të prekë jo vetëm ndjenjat e shikuesit por të shkojë më thellë se sa ndjenjat. Këto figura skulpturore metalike, nëpërmjet "përdredhjes" së tyre me shumë elegancë, duke mos fshehur aspak konstruktin e metalit, i bëjnë të perceptueshme nëpërmjet shqisave tona, konceptet e këtij skulptori.

"Një vepër e hapur" ndërvepruese që të fton të marrësh pjesë, thotë Philippe Parreno, i jep një farë koordinate marrësit, ajo i mundëson atij të reagojë ndaj shtytës fillestare të dhënë nga lëshuesi i kumtit. Pra qëllimi i skulptorit është të arrihet nëpërmjet forcës ndikuese të krijimit një kompromis i besueshëm mes këtyre formave dhe koncepteve të tij. Përfundohet pra ndjesia që krijuesi i këtyre formave na mundëson të shohim nëpërmjet ngjyrimit artistik, se ato kanë vitalitetin e vet, një energji të ndrydhur, të konservuar, të brendshme intense. Edhe pse nuk riprodhojnë paraqitjen natyrore, ato transmetojnë tek shikuesi një ekspresion të domethënies së jetës.

Jam plotësisht i bindur se autori i këtyre formave tepër provokuese (mbase i shtyrë nga fillesa Dionisiane), rrugëtoi drejt zgjidhjes dhe dhënies jetë të tyre, falë talentit, intuitës e këmbënguljes për të zbuluar forma të reja shprehjeje, eksperiencës dhe nga sugjestionet që i japin atij format dhe struktura e materialit.

Por ashtu si dhe krijues të tjerë pasionantë, përpara se të arrijë destinacionin, ai mbetet i mbërthyer nga vrulli krijues. Thënë ndryshe, antenat e ngritura lart, funksionojnë tek ai pandërprerje. Që do të thotë se duke gjetur (zbuluar) motivin nga natyra, nga jeta, apo duke i përjetuar ato nëpërmjet ëndrrave,

Pedagogu Prifti sjell mendimin e tij për ekspozitën "Prolog" të artistit Kristo Krisiko dhe argumenton se çfarë solli ajo për mjedisin e artit pamor shqiptar

## Përqasje e gjetur mrekullisht mes materialit qeramik dhe metalit



ky krijues, ashtu si dhe të tjerë mbarsur me veti të tilla, zbulon atë që prej kohësh ai filozofon. Jo një ide të fiksuar pa jetë, por një ide plot me sugjestion. Dhe unë personalisht mendoj se kur ato janë më shumë abstrakte, janë më shumë vitale. Por kureshtja për veprën, për të shkuar më thellë brenda saj, nuk mbaron këtu.

Përveç subjektit të realizimit teknik në shërbim të qëllimit të formës, të një objekti të tillë me destinacion të caktuar estetik, për tu vendosur në një ambient të hapur për publikun, marrin pjesë subjektin, madhësia, materiali, gjetja e përshtatshme e vendit në raport me sipërfaqen, ngjyra e tjerë. Por unë desha të veçoj një element tepër të rëndësishëm të cilësuar nga ky krijues, atë të ritmit. Ai është elementi mjaft i rëndësishëm në këto vepër skulpturore me destinacion të tillë. Praktikisht atë e shohim të ekzekutuar mjeshtërisht nga krijuesi i tyre dhe ato presin të instalohe në ndonjë nga parqet e vendit. Personalisht e shoh të real-


izuar bukur, mjeshtërisht mes hapësirave të lëna, të konturuara shijshëm me linja harkore të formave plastike me madhësi të ndryshme, tonacioneve të krijuara enkas në sipërfaqen e tyre, duke e çuar shikuesin drejt një imazhi më të thellë, më të plotë e gjithëpërfshirës. E si rrjedhojë na bën thirrje për ta zbuluar, ta shijojmë por edhe ta perceptojmë të bukurën, forcën tërheqëse estetike që rritim (si ndjesi e autorit, krijuesit të saj) si i domosdoshëm e si pjesë e estetikës, na ofron. Krijuesi i tyre, një artist i talentuar nëpërmjet këtyre marrëdhënieve harmonike të elementëve skulpturore nën udhëheqësinë e ritmit, synon gjithashtu të lëndësojë në një formë ose në një tjetër, marrëdhënie e tyre me hapësirën dhe kohën.

Për mendimin tim, vepër e një profili të tillë do të qendronin mjaft mirë si skulptura parku, duke u bërë pjesë e një ambienti me gjelbërim dhe me frekuentues (të rinj a të moshuar). Ka kohë që flitet një gjë e tillë në qytetin tonë. Ky është një rast i mirë për tu shfrytëzuar. Le të shpresojmë.

### NJË ANALIZË E VEÇANTË PËR RELIEVIN E DESTINUAR TË VENDOSËT NË MURIN JUGOR TË BANKËS KOMBËTARE SHQIPTARE.

#### Për artin e tij

Krijoi bindjen se këto forma (të realizuara, të jetësuar në relievin e krijuesit artist Kristo Krisiko, nuk do mund të gjenin zhvillim nga një artist me formim akademik, të cilët për kohën që flitet nuk mungonin. Ajo që unë do doja është të përforcoj atë çfarë thashë më sipër, se është talenti, intuita, këmbëngulja si dhe edukimi profesional i trashëguar nga mësimdhënësi (që pati fatin ti ketë). Aftësia e tij për të rrëmbyer prej tyre edhe të pathënat të cilat kalojnë në sistemin mendor të "nënësimit" fare pa e kuptuar.



#### VEPRA TË KËTJË AUTORIT QË JANË NË FONDIN E GALERISË KOMBËTARE

1. ONUFRI
2. STAFETA
3. MONTATORJA
4. DORA D'ISTRIA
5. KULTURA ILIRE
6. MYZEQE
7. RIVIERA
8. FLAUTISTJA

Gjatë këtij rrugëtimi duke eksperimentuar nëpërmjet boceteve, format e në veçanti figurat morën jetë dhe ndoqën një zhvillim logjik të cilin artisti, krijuesi i tyre, siç thotë Henry Moore, (një nga më të njohurit e fundshkullit të XX<sup>th</sup>), "artisti, krijuesi apo kushdo qoftë ai, edhe po të donte, nuk do mund ta ndryshonte rrjedhën e tyre". Kjo përforcon mendimin se ekziston jo vetëm forma e jetës, formë që buron nga natyra, por gjithashtu një jetë formash. Në zhvillimin e një artisti metribute të veçanta, format tipike zhvillohen jashtë njëra-tjetrës dhe madje, siç e kemi përmendur më lart, janë më shumë abstrakte; ato janë më shumë vitale – thotë Henry Moore.

E kështu krijoi bindjen se këto forma (të





Opinion *i* Ditës

# "E lagu s'e lagu" i sotëm politik

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... mjeshtër të fjalive të bukurave dhe të batutave të forta, të shprehjeve të gjetura për të kanalizuar zhgënjimin tonë të momentit, apo dëshpërimin nga varfëria dhe mungesa e të ardhmes për ne dhe fëmijët tanë në vendin tonë. Jemi ende ndër shtetet më të varfëra të Evropës. Vlera e shtuar e mallrave dhe shërbimeve tona është e dyta nga fundi, para Moldavisë dhe pas Kosovës. Dhe megjithatë, vëmendja e atyre që kemi votuar nuk ndodhet përditë tek sfidat e daljes sonë nga mjerimi, varfëria dhe mungesa e perspektivës. Shumë mirë bëri kryeministri më 9 janar që shkoi mes sipërmarrësve të vegjël (punishte mobileri druri) në Paskuqan, të cilët me paketën e re të tatimeve për këtë vit paguajne tre herë më pak tatim mbi fitimin. Edhe pse këto lëvizje në nivelet e taksave nuk pëlqehen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Shumë mirë ka bërë kohë më parë Lëvizja Socialiste për Integrim me paketën e propozuar prej saj për industrinë fason, sektori që punëson më shumë për para të investuara në të. Shumë mirë ka bërë Partia Demokratike që i qëndron fort propozimit të saj për një taksë të sheshitë 9 përqind, që mund të rigjenerojë ekonominë tonë. Por këto propozime dhe veprime duhet të ndiqen çdo ditë. Jo vetëm kur propozohet një paketë taksash apo miratohet një buxhet. I kemi votuar të mendojnë e punojnë çdo ditë për përmirësimin e gjendjes sonë



ekonomike, përpara gjithshkaje tjetër: Udhëheqja e Organizatës për Sigurimin në Evropë (OSBE) nga Shqipëria një vit më vonë nuk është se do të na sjellë vende të reja pune. Sigurisht imazhi i vendit do të rritet, por ne duam zgjidhje ekonomike sot. Të 700 milionë eurot e katër rrugëve të reja të kontraktuara gjatë vitit 2018 ndoshta edhe mund të mos përzgjidheshin nga kjo qeveri që sot kemi mbi krye. Prandaj ngrejme pyetjet: a

mund të priste rruga Thumanë-Vorë me vlerë 250 milionë euro? A mund të priste edhe disa vjet rruga Milot-Balldren me vlerë 100 milionë euro? Nuk kemi deri tani rrugë për të shkuar në Vorë dhe në Balldren? Kemi, si jo, madje jo vetëm një. Sikur gjysma e këtyre parave, 175 milionë euro të ishin investuar në bujqësinë dhe turizmin tonë, në vend të rreth 950 vendeve pune për punëtorë sezonalë që këto rrugë do të hapin si

kantiere ndërtimi derisa sa rrugët të bëhen, do të kishim 15 mijë vende të reja të përhershme pune në bujqësinë për treg dhe eksport dhe në turizmin e detit, si dhe në atë rural dhe malor. Dhe nuk i kemi, pse kjo qeveri ka zgjedhur të bëhet njësh me oligarkët. Ka zgjedhur t'u marrë para borxh ne dhe fëmijëve tanë për sot dhe për 10 e 20 vite të tjera, nëpërmjet kontratave partneritet publik-privat (PPP), që po rrisin detyrimet e Buxhetit të Sh-

tetit kapiçë vit pas viti. Dhe për asgjë nga këto probleme themelore tonat dhe si mund të zgjidhen ato nuk po dëgjojmë të flitet sot. Ose të ngrihet i ashpër diskutimi, duke kërkuar që këto kontrata vrasëse të së ardhmes sonë ekonomike të kthehen mbrapsht, sikurse ndodhi me institucionin e protestës studentore në dhjetor 2018, i cili ktheu mbrapsht tarifën për provimet e studentëve përsëritës dhe përgjysmoi tarifën rrjepëse për 129 mijë studentë të arsimit tonë të lartë publik. Jo, në këtë vit e kemi filluar me emërimet dhe ç'emërimet ministrash. Sikur një ministër i ri apo i vjetër do të na hapë më shumë vende pune apo të na sjellë më shumë investime të huaja, për t'u punësuar më shumë! Prandaj dhe "e lagu, s'e lagu" i emërimeve apo ç'emërimeve, të ngurta në qiel nga media të eksituar në personalizime politikash bosh që vetëm na kanë përmbytur me diskutime mjerane, po kontribuon në largimin nga vëmendja e politikës dhe e qeverisë tek problemet dhe hallet e mprehta që po kalojmë. Kështu përballohet edhe më lehtë ngjarja e rëndë e falsifikimit të dokumenteve në dy tendera shtetërorë me vlerë 30 milionë euro, një kapje e përbindshme e shtetit tonë, për të cilën duhet të përgjigjen deri më një ideatorët e saj. Kush i fryn "e lagu, s'e lagu"-t të diskutimeve politike të sotme, thjesht qetëson këtë plagë të stërmadhe në padrejtesitë e bëra me tenderat publikë shqiptarë këto 26 vitet e fundit, e cila duhet të rrjedhë gjak dhe të mos mbyllet si shumë simotra të saj, për të nxjerrë lakuriq aventurierët publikë me paratë e shqiptarëve.

Opinion i Ditës

# Kush qe Çani, Edi apo Ariani?

Nga Andi Bushati

(vlon nga faqja 1)

...e të re në paraqitjen e tij përballë Arian Çanit. Ai drejtoi vështrimin nga kamera, bëri një pauzë të gjatë, simuloi një vuajtje që i buronte nga përbrenda dhe iu drejtua publikut gjithë dhimbje: "Jini të kujdesshëm, se nuk e kanë me mua, por me ju".

Shigjetimi ishte për Ilir Metën që nuk dekretoi për ministër të Jashtëm, Gent Cakajn dhe për të gjithë ata që e kanë mbështetur këtë akt.

Sipas kryeministrit, i tërë ky grupim, i shtrirë nga Tirana në Prishtinë, nxitet nga ndjenja e errët e xhelozisë për të rinjtë, nga armiqësia për modelin e tyre të panjollë dhe të pamëkatshtëm, nga mbrapshtësia për të mos i lënë të afrohen të dy pjesët e mëdha të kombit.

Pasi renditi këto argumente, shefi i qeverisë u kthye sërish nga kamera për t'i folur publikut: "Unë jam këtu për t'u mbrojtur nga kjo lukuni që kërkon të marrë peng të ardhmen tuaj".

Megenëse përpos debatit juridik (a duhej apo jo certifikata), Edi Rama e trajtoi konfliktin e fundit edhe në sferën shoqërore dhe politike, të paceskur deri më tani, patjetër që është interesante të ndalesh edhe tek ajo.

Dhe në këtë kuptim rasti i Gent Cakajt është mjaft ilustrues për të gjithë tërmetin e fundit që pësoi qeverisja e rilindjes.

Ai është simboli i kësaj aradhe, ndoshta ekspertësh të rinj, të shkolluar, por që nuk kanë lidhje as me meritokracinë e ngjitjes në politikë, as me karrierën brenda partisë që i mandaton dhe as me shqiptarët, të cilëve ua kanë kërkuar votën të tjera personazhe.

Pra, në kuptimin shoqëror dhe politik, katapultimi i Gent Cakajt dhe ministrave të ngjashëm si ai, mbetet i papranueshëm.

Ndryshe nga sa thotë Rama, ai nuk është një garanci për të ardhme më të mirë dhe më demokratike për shqiptarët, por rrëshqitja drejt një pushteti personal, të ngjashëm me atë të "vëlait Erdogan" apo të princit trashëgimtar të Arabisë Saudite, Mohammed ben Salmane Al Saud.

Në asnjë model të mirëfilltë vendi demokratik, askund, nuk mund të ekzistojë një kabinet me kaq figura të panjohura dhe pa pikë lidhje me partinë që ka në duar pushtetin.

Në asnjë sistem perëndimor nuk gjenden kaq ministra të pastestuar përmes votës së qytetarëve.

Vërtet Edi Rama në shfaqjen me tepsi në dorë në verën e 2017, u kërkoi shqiptarëve i vetëm pushtetin, por kjo kërkesë kishte të bënte me shkëputjen nga aleatët politikë dhe aspak me një mandat të pakufishëm për të bërë ç'ti donte qejfi.



Në këtë kuptim, ndryshe nga sa u thotë shikuesve me sy të ngulur nga kamera, ata po i tradhton ai vetë. Ai po bëhet pengesë për një sistem të hapur, me rregulla loje, ku vlera e votimit e ul voluntarizmin individual.

Me Gent Cakajn dhe me shumë të singjashmit e tij në kabinet, ai kaloi çdo limit të delegimit të pushtetit në duart e veta. Prandaj edhe për këtë i duhej thënë ndal me të gjitha mjetet ligjore apo ekstra ligjore qofshin ato.

Por, përtej këtij problemi disi

teorik, qëndron edhe një tjetër, tejet më praktik. Ai lidhet kryesisht me komunikimin dhe me tendencën e Edi Ramës për ta shitur të zezen për të bardhë.

Si ka mundësi që edhe regresin e ndryshimeve të fundit në qeveri, ai u mundua ta paraqesë, në "Zonë e Lirë", si një garanci më shumë për shqiptarët? Si ka mundësi që akte të tilla të paimagjinueshme për çdo demokraci normale, ai i reklamoi si digë ndaj frontit lokal të së keqes?

Dhe këtu kthehemi sërish tek

ajo që pamë që në fillim të shfaqjes së tij përballë Arian Çanit.

Tek talenti i konfirmuar i një aktori të mirë, që duhet të shfaqë në skenë një personazh të ngjizur keq. Sepse këtë bëri Edi Rama të premtën në mbrëmje. Këtë përsëriti edhe një javë më parë tek Ermali. Këtë model shumëfishon edhe me postimet në rrjetet sociale.

Prej kohësh ai do të pompojë sozinë duke fshehur të vërtetin. Ai do rolin dhe jo realitetin.

Prej kohësh e ka kuptuar se është më mirë që njerëzit ta përqeshin si karagoz, sesa ta urrejnë si mafioz, ta neverisin për lakuriqësinë, sesa ta luftojnë për grykësinë.

Prandaj, në "Zonë e Lirë", ai u mundua të jetë ai që nuk është. Prandaj zgjodhi atë emision, autori i të cilit ka aftësinë e dyfishtë që të luajë vetveten. Dhe e bëri mirë. Aq sa të premtën tek Çani, ishte shumë e vështirë të dalloje, kush qe Rama dhe kush qe Ariani.

Ai është simboli i kësaj aradhe, ndoshta ekspertësh të rinj, të shkolluar, por që nuk kanë lidhje as me meritokracinë e ngjitjes në politikë, as me karrierën brenda partisë që i mandaton dhe as me shqiptarët, të cilëve ua kanë kërkuar votën të tjera personazhe.

## HOROSKOPI

### DASHI

Për të lindurit në këtë shenjë, kjo ditë do t'ju përballë me një sfidë. Mos u frikësoni dhe mos dyshoni në suksesin tuaj, pasi do t'ju mbështesin miqtë më të afërt. Në dashuri keni besim tek vetja juaj dhe anashkaloni këshilltarët e "mençur".

### DEMI

Do të kujtoni një moment të bukur, i cili do t'ju bëjë të harroni problemet që keni. Do keni kënaqësi dhe mendje të qetë, por nuk duhet të harroni premtimet që i keni bërë një mikut tuaj të ngushtë. Mbrëmja do të mbyllet me një valë pozitive nën hijen e një romance..

### BINJAKET

Për binjakët data 13 janar do të jetë plot surpriza dhe plot emocione të ndryshme. Dita do të vijojë me një takim të rastësishëm, ndërsa në fund të saj një problem brenda familjes do t'ju shqetësojë paksa, por me zgjuarsinë tuaj do të zgjidhni gjithçka.

### GAFORJA

Për gaforret, dita e diel do të kalojë pa vënë re. Çështjet e brendshme, udhëtimet e vogla janë prioritet këtë ditë. Të afërmit ose miqtë do të kërkojnë vëmendje të veçantë, ndaj nëse ua kushtoni do të eliminoni problemet e tyre.

### LUANI

Menaxhimi i kohës dhe kursimi i energjisë do t'ju ndihmojnë të arrihi qëllimet tuaja sot. Detyra kryesore e së dielës mund të jenë punët e shtëpisë, argëtimi me fëmijët. Në një moment do të dëgjeni një telefonatë ku partneri juaj ju shpreh ndjenjat.

### VRIGJERESHA

Kjo do të jetë një ditë reflektimi për të lindurit e kësaj shenje. Çështjet financiare dhe të brendshme nuk do të kërkojnë energji nga ju. Nuk është dita e duhur për të bërë shpenzime të shtrenjta, ndaj mund t'i lini ato për një ditë tjetër.

### PESHORJA

Dita e sotme do të këtë nuanca negative, e cila mund t'ju prishtë planet e fundjavës. Dikush që nuk ka marrë atë që donte prej jush, do t'ju shqetësojë. Për këtë do të keni një mugëdalje, mosveprimi i menjëhershëm në fund të ditës.

### AKREPI

Edhe pse dëshira e akrepëve për të pushtuar këtë të diele do të jetë e madhe, ajo duket paksa e pamundur. Dita do t'ju marrë kohën më të madhe duke pastruar shtëpinë dhe duke u përgatitur për një javë të re në punë.

### SHIGJETARI

Ndodhite e së dielës do të kënaqin shigjetarët. Dëshira për të ndenjur me miqtë, për të organizuar një festë do të jetë e madhe, por duhet të merrni në konsideratë edhe mendimin e familjes, pasi nga ata që mund të mërziten nga kjo që.

### BRICJAPI

Kjo do të jetë një ditë me fat për Bricjapët në çështje, të cilat do të sjellin fitime financiare të kënaqshme. Por nga ana tjetër për sa i përket miqësisë, dashurisë dhe familjes do të përballeni me një situatë të tensionuar.


### UJORI

Këtë ditë Ujori do të shohë vetëm përpara dhe ajo që do t'i duket si një vend i errët së shpejti do të perceptohet si një vend plot dritë. Fundi i ditës rrit gjasat e udhëtimeve dhe takimeve të suksesshme.

### PESHQIT

Sot Peshqit rezikojnë të humbasin harmoninë e tyre të brendshme. Mund të jetë e nevojshme të kërkoni ndihmë për të rivendosur ekuilibrin emocional. Për sa i përket ndjenjave, ju nuk do të ndiheni të kënaqur për shkak të disa ngjarje të pakëndshme.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- 2. Një pikturë vetes.
- 11. Lindgren e Pippi çorapegjatës.
- 13. Thirrej edhe kështu Persefoni.
- 14. Hapin ekspozitën.
- 16. Ruhet pa cifte.
- 18. Shiroka aktor.
- 19. Fillojnë masat.
- 20. Të parat në aksion.
- 21. Eshhtë gara më e gjatë.
- 25. Inicialet Pacino-s.
- 26. Janë sponsor të Tiranës.
- 28. Pavone këngëtare.
- 29. Kështu thirrej Marco Pantani.
- 30. Dieta pa ekstreme.
- 32. Janë salla për projeksione.
- 33. Duhet çarë më dritë.
- 36. Italia në tabela.
- 37. Janë katrorë në sipërfaqe.
- 38. Williams tenisiste.
- 40. Në fillim të verës.

- 41. Cocker këngëtar.
- 43. Të fundit në tender.
- 44. Janë fletë trëndafili.
- 48. Fillojnë ideologjinë.
- 49. Eshhtë krahinë e Athinës.
- 51. Emri i Zola.
- 52. Hari spiune.
- 53. Janë kulla në xhami.

**VERTIKAL**

- 1. Njësi matëse për kondensator.
- 2. Artet pa re.
- 3. Fillojnë uraganin.
- 4. Nisin titrimin.
- 5. Janë në modë.
- 6. Inicialet e Kokoschka-s
- 7. Një mund të jetë ekspres.
- 8. Mund të jenë ushtarake.
- 9. Jepen për hartim.
- 10. Janë të lira për hartim.
- 12. Eshhtë magjik ai i fatave
- 15. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- 17. Një organizatë humanitare
- 21. Janë shkurre.
- 22. Janë kapo kozakë.
- 23. Nino kompozitor.
- 24. Fillojnë teorinë.
- 27. Kryqyteti i asirëve.
- 31. Një verë në Paris.
- 32. Një vepër si romani.
- 34. Mbyllin një sherr
- 35. Kompozoi një Bolero.
- 37. Pak mbeturina
- 39. Një bëhet për të mirë.
- 42. Eshhtë dhomë.
- 44. Peter që humb hijen
- 45. Një pjesë e territorit.
- 46. Pak amerikanë.
- 47. Gjysmë litari.
- 49. Dy asa.
- 50. Kalimi në kufij.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- 1. Mondrian piktor.
- 5. Safin tenist.
- 9. Eshhtë e re pas Krishtit.
- 10. Janë grimca të familjes së adroneve të tilla.
- 12. Fillojnë matematikën
- 13. Mbarojnë fare
- 14. Josa trainer.
- 15. Në mes të dhomës.
- 17. Gjysma e inatit.
- 19. Ishin shkolla edukimi.
- 22. Janë ritransmetues televizivë.
- 24. Ishte djali që vrau Odiseun.
- 25. Një pjesë e opozitës
- 27. Një ekspres në binarë.
- 29. Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
- 30. Mund të lakohen.
- 32. Një yll me bisht.
- 34. Italia në Internet.

**VERTIKAL**


- 35. Edouard piktor.
- 37. Shahu i fundit.
- 38. Gjysma e aortës.
- 40. Efekti... i François Truffaut.
- 41. Inicialet e Lendl
- 42. Kufizojnë një kënd.
- 44. Polanski regjisor.
- 46. Skuadër greke.
- 48. Britma e Arkimedit.
- 49. Egoyan regjisor.
- 50. Fillojnë turnin.
- 1. Ishte shkolla e Arkimedit.
- 2. Grandi këngëtare
- 3. Diftong teatral
- 4. I përkasin stinës së nxehtë.
- 5. Një shishe bombë.
- 6. Janë në qendër.
- 7. Ndiqet nga një mi
- 8. Janë këngëtarë lirikë.
- 10. Emër burri.
- 11. Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
- 15. Botom pa ekstreme.
- 16. Eshhtë figurë letrare.
- 18. Eshhtë enë kryesore gjaku.
- 20. Një pikë në ligj
- 21. Risia pa kufij
- 23. Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
- 26. Janë fletë trëndafili.
- 28. Robert Mitchum.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Eshhtë si fatë.
- 32. Gjysma e ketrit.
- 33. Carolina e belle epoques.
- 36. U shkrua nga Zola.
- 39. Me të bëhet trokë.
- 43. Duket në parat
- 45. Maten të parat.
- 47. Të parat në kufij.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

ERASMI PAKETETAT  
LORIS KUMARI  
UNIK SANPSE  
AMESIMOREG  
RABMEREMETIMET  
DELIKATE TIVLA  
SARAFET RACER  
TRATIT MOLLINE  
NIGENARENAT  
BESSETERTI  
ATEAETASAKRA  
NARKRITEMA  
FAZAR KABINETE  
TRONMETITIMZ  
TMEKETITRID  
TARTARTONION  
TMTITANETNA  
KASAMARITANE  
ELIMANE DESH  
SOLANAKTECE  
TUBORG UEREROS  
ODSAAARENADIA  
KANNSARAHIEP  
ENDEKATEETI

**FJALËKRYQI (2)**

SLIMIA  
OFEKASAIIS  
KOFANATIKET  
AFENOMENALE  
KARAMELEIR  
KNADARRRO  
OITALIARRO  
FAELIKONAT  
IRTOTALITAR  
NAFDENSHIT  
ITERREDEEAP

**SUDOKU**

	5	8						9
			7	5				2
	3	1	9					4
					9	4		
9		3					1	6
		6	8					
	6				8	5	1	
		7		9	5			
	9						7	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	5	2	9	8	3	7	1	4
8	7	9	1	4	5	6	2	3
1	3	4	6	7	2	8	5	9
2	6	1	3	9	4	5	7	8
7	4	3	8	5	1	2	9	6
5	9	8	2	6	7	3	4	1
3	1	5	4	2	6	9	8	7
9	2	6	7	1	8	4	3	5
4	8	7	5	3	9	1	6	2

*Argëtim filozofik*

Nëse i detyrosh bankës 100 milionë dollarë, atëherë është problemi i bankës.

- Gjithçka që kërkoi është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të lumtur.

- "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse nuk jam atje, shkoj në punë".

- "Ndryshimi mes një divorci dhe një ndarjeje ligjore është se ndarja ligjore i jep burrit kohë për të fshehur paratë e tij"

- "Nëse mendon se askujt nuk i intereson nëse je gjallë, provo të mos paguash dy muaj fatura"

*Thënie të mençura*

- "Mos u gënjoni duke besuar se një njeri i pasur është domosdo i zgjuar. Ka mjaft prova që vërtetojnë të kundërtën".
- - "Emancipimi i grave është i mirë ; por para duhet mbi të gjitha ti mësojmë asaj përdorimin e lirisë."
- - Në shumicën e vëndeve, qytetarët e kanë të drejtën e fjalës. Por në një demokraci, ata kanë ende lirinë mbasi kanë folur.
- - Miku, natën e parë është flori, natën e dytë bakër, natën e tretë teneqe.

